



Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-(SHSKUK)

Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)

“Pyetje me përgjigje të shumëfishta
për rekrutimin e infermierëve në SHSKUK”

Përmbajtja:

Hyrje.....	3
Pjesa I.....	4
Kreu 1: Pyetje Profesionale.....	4
Pjesa II.....	76
Kreu 1: Njohuri mbi Kushtetutën e Republikës së Kosovës.....	76
Kreu 2: Pyetje nga e njohuritë mbi procedimin administrativ (Ligji i procedurave administrative dhe ai për konfliktet administrative).....	85
Pjesa III. Aftësi të Përgjithshme: arsyetimi dhe të menduarit në mënyrë llogjike dhe analitike.....	105
Kreu 1: Pyetje të llogjikës – matematikë bazike	105
Kreu 3: Pyetje të llogjikës – arsyetuese, deduksionit dhe të aftësive për zgjidhjen e problemeve.....	110

Hyrje

Këto pyetje janë përgatitur për t'u përdorur në procesin e rekrutimit të infermierëve në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (SHSKUK). Ato janë hartuar nga njësitë përkatëse profesionale të SHSKUK-së, duke u bazuar në kërkesat dhe standardet aktuale të praktikës infermierore.

Qëllimi i tyre është të mundësojnë një vlerësim sa më të drejtë, objektiv dhe transparent të njohurive profesionale, aftësive praktike dhe kompetencave të kandidatëve që aplikojnë për pozitën e infermierit.

Pyetjet mbulojnë fusha të rëndësishme të praktikës infermierore, etikës profesionale, sigurisë së pacientit dhe ofrimit të kujdesit cilësor shëndetësor.

Pjesa e njohurive mbi Kushtetuten e Republikës së Kosovës, nga njohuritë mbi procedimin administrative dhe aftësi të përgjithshme logjike janë marrur nga fondi i pyetjeve të Ministrisë së Administratës Publike.

Për të garantuar paanshmëri dhe barazi në procesin e testimit, pyetjet do të përzgjidhen në mënyrë të rastësishme përmes sistemit kompjuterik. Kjo mënyrë përzgjedhjeje synon të sigurojë transparencë, integritet dhe standardizim në vlerësimin e kandidatëve.

Nëpërmjet këtij procesi, SHSKUK synon të përzgjedhë kandidatë të përgatitur profesionalisht, të përgjegjshëm dhe të aftë për të ofruar shërbime infermierore cilësore në përputhje me standardet institucionale dhe profesionale.

Pjesa I

Kreu 1: Pyetje Profesionale

1. Si ndikon hiperventilimi në vlerat e analizave gazore te pacienti?

- a. rrit PaCO₂ dhe ul pH-në
- b. shkakton alkalozë respiratore
- c. rrit pH-në e gjakut
- d. ul presionin parcial të CO₂ (PaCO₂)
- e. shkakton acidozë metabolike primare

2. Cili ritëm i zemrës duhet raportuar menjëherë gjatë monitorimit telemetrik?

- a. bradikardia sinusale fiziologjike
- b. fibrilacioni ventrikular
- c. ritmi sinus me ekstrasistole të rralla
- d. blloku AV komplet
- e. takikardia ventrikulare

3. Cili parametër tregon perfuzion të dobët periferik?

- a. ekstremitete të ftohta
- b. mukozë orale e lagësht
- c. mbushja kapilare e zgjatur
- d. temperaturë aksilare e rritur
- e. pulse periferike të dobëta

4. Pse është i rëndësishëm monitorimi i diurezës te pacienti në rrezik për shok?

- a. reflekton volumin qarkullues efektiv
- b. sinjalizon përkeqësim të shokut
- c. tregon funksionin e mëlçisë
- d. mat drejtpërdrejt presionin intrakranial
- e. vlerëson perfuzionin renal

5. Cili ndryshim i vetëdijes sugjeron hipoksi cerebrale?

- a. ulje e orientimit
- b. agjitacion ose shqetësim i papritur
- c. rritje e oreksit
- d. konfuzion akut
- e. hiperaktivitet motorik pa hipoksi

6. Cili është vendi më i sigurt për injektim intramuskular te të rriturit?

- a. muskuli pektoral
- b. ventrogluteal
- c. deltoid i sipërm medialisht
- d. kuadranti i brendshëm gluteal
- e. parakrahu anterior

7. Cila venë përdoret më shpesh për vendosje të VVP (kateter periferik)?

- a. vena cefalike
- b. vena radiale arteriale
- c. vena sublinguale
- d. vena jugulare e jashtme
- e. vena femorale

8. Pse shmanget kuadranti i brendshëm i gluteusit për injektime?

- a. rrezikut për pneumotoraks
- b. përthithjes më të shpejtë të barit
- c. rrezikut të dëmtimit të nervit shiatik
- d. rrezikut të lëndimit të enëve të mëdha
- e. rrezikut për dëmtim të tendonit të Akilit

9. Cila strukturë duhet shmangur gjatë vendosjes së sondës nazogastrike?

- a. ezofagu torakal distal
- b. duodenumi
- c. trakea
- d. stomaku
- e. ezofagu abdominal

10. Si manifestohet dëmtimi i nervit radial?

- a. pamundësi për plantarfleksion
- b. pamundësi për ekstenzion të kyçit dhe gishtërinjve
- c. çrregullim sensitiv në dorsumin e dorës
- d. devijim ulnar i gishtërinjve
- e. rënie e dorës në fleksion (wrist drop)

11. Cila është shenja kryesore që infermieri duhet të monitorojë pas administrimit të opioidëve?

- a. rritja e diurezës
- b. depresioni respirator
- c. ulja e frekuencës respiratore
- d. ulja e saturimit të oksigjenit
- e. hiperrefleksia osteotendinoze

12. Para administrimit të aminoglikozideve duhet kontrolluar:

- a. niveli i bilirubinës
- b. kreatinina serike
- c. koha e protrombinës
- d. diureza
- e. funksioni i dëgjimit

13. Cila është shenja e efektit të mirë të diuretikëve të ansës?

- a. lehtësimi i dispnesë nga mbingarkesa me lëngje
- b. rritja e kreatininës
- c. rritja e diurezës
- d. shfaqja e tinitusit
- e. ulja e edemës

14. Cili është treguesi më i rëndësishëm i toksicitetit nga digoksina?

- a. sedacion i thellë
- b. nauze e lehtë pas ushqimit
- c. rritje e oreksit
- d. hipertermi
- e. aritmi ose bradikardi e re

15. Pse duhet kontrolluar vendi i infuzionit të medikamenteve irrituese?

- a. për të vlerësuar refleksin pupilar
- b. për të zbuluar infiltrimin në kohë
- c. për të matur presionin venoz qendror
- d. për të reduktuar hemolizën
- e. për të parandaluar ekstravazimin dhe nekrozën e indeve

16. Cili veprim parandalon më shumë infeksionin nga kateteri periferik?

- a. higjiena e duarve para manipulimit
- b. larja e kateterit me glukozë hipertoniqe
- c. ndërrimi korrekt i fashës sipas protokollit
- d. teknika aseptike gjatë vendosjes
- e. prekja e shpeshtë e vendit për kontroll

17. Cila është mënyra korrekte për marrjen e urinës?

- a. mbledhje e urinës së rrjedhës së mesme
- b. ruajtje në temperaturë dhome për disa orë
- c. pastrim i zonës perineale para marrjes së mostrës
- d. prekje e brendshme e enës sterile
- e. marrje nga qesja e drenazhit urinar

18. Cili lloj izolimi kërkohet për pacientët me tuberkuloz pulmonar aktiv?

- a. dhomë me presion negativ
- b. izolim me pika pa respirator
- c. izolim ajror
- d. maskë N95/FFP2 për stafin
- e. vetëm doreza sterile

19. Cila masë ul përhapjen e MRSA?

- a. higjiena rigoroze e duarve
- b. ventilim me presion pozitiv
- c. ndalim i plotë i mobilizimit
- d. izolim kontakti
- e. pajisje të dedikuara për pacientin

20. Cila është ndërhyrja më e rëndësishme infermiere për të parandaluar pneumoninë nasokomiale tek pacientët e ventiluar mekanikisht?

- a. pozicion i sheshtë supin
- b. ngritja e kokës së krevatit 30-45°
- c. parandalimi i aspirimit të sekrecioneve
- d. kujdesi oral i rregullt
- e. kufizimi i hidratimit total

21. Cili është prioriteti kryesor infermieror pas një laparotomie?

- a. sigurimi i rrugëve të frymëmarrjes dhe oksigjenimit
- b. monitorimi i shenjave vitale
- c. ushqyerja enterale e menjëhershme
- d. mobilizimi pa vlerësim paraprak
- e. vlerësimi i hemorragjisë dhe dhimbjes

22. Kur duhet raportuar drenazhi kirurgjikal?

- a. kur drenazhi rritet papritur
- b. kur pacienti fle qetë
- c. kur bëhet i kuq i ndezur
- d. kur merr erë të keqe
- e. kur sasia është minimale

23. Cila është një nga vendndodhjet më të zakonshme për vendosjen e kanulës venoze?

- a. vena cefalike e parakrahut
- b. arteria brachiale
- c. vena bazilike
- d. vena cava inferior
- e. venat dorsale të dorës

24. Cila metodë jo-farmakologjike lehtëson dhimbjen postoperatore?

- a. ripozicionimi i kujdesshëm
- b. pirja e kafesë së fortë
- c. teknikat e relaksimit dhe frymëmarrjes
- d. ulja e krevatit pa mbështetje
- e. mbështetja e plagës me jastëk gjatë kollës

25. Para ngritjes së parë pas operacionit vlerësohet:

- a. forca dhe gjendja e përgjithshme
- b. presioni arterial dhe toleranca ortostatike
- c. vetëm madhësia e pupilave
- d. vetëm ngjyra e flokëve
- e. niveli i dhimbjes

26. Bilanci i lëngjeve dokumentohet për të vlerësuar:

- a. funksionin renal
- b. statusin e hidratimit
- c. vetëm numrin e eritrociteve
- d. vetëm peshën ideale teorike
- e. përgjigjen ndaj terapisë me lëngje ose diuretikë

27. Cila masë parandalon trombozën?

- a. kufizimi absolut i lëvizjes
- b. ushtrimet aktive/pasive të këmbëve
- c. mbajtja e këmbëve të varura gjatë gjithë ditës
- d. çorapet kompresive ose profilaksia sipas udhëzimeve
- e. mobilizimi i hershëm

28. Cila shenjë tregon fillimin e rikthimit të funksionit të zorrëve?

- a. rritja e elasticitetit të lëkurës
- b. defekimi
- c. kalimi i gazrave
- d. ulja e hematokritit
- e. rikthimi i zhurmave intestinale

29. Hemorragjia e fshehtë dyshohet kur paraqitet:

- a. hipotensioni
- b. mioza bilaterale
- c. takikardia
- d. rritja e oreksit
- e. lëkura e zbehtë dhe e ftohtë

30. Roli infermieror në stomë përfshin:

- a. kujdesin për lëkurën peristomale
- b. kufizimin e plotë të marrjes së lëngjeve pa urdhëzime
- c. vlerësimin e ngjyrës dhe perfuzionit të stomës
- d. matjen e ICP
- e. edukimin e pacientit për menaxhimin e stomës

31. Cila shenjë sugjeron dekompensim në insuficiencë kardiake?

- a. ulje e pulsit radial pas ushtrimit
- b. ortopne ose edemë progresive
- c. krepitacione pulmonare
- d. rritje e refleksit patelar
- e. dispne në rritje

32. Cila vlerë e tensionit kërkon ndërhyrje urgjente?

- a. TA 140/85 mmHg pas ecjes
- b. presion sistolik ≥ 180 mmHg me simptoma
- c. presion diastolik ≥ 120 mmHg me shenja të dëmtimit të organeve
- d. TA 118/70 mmHg në pushim
- e. TA 130/80 mmHg pa ankesa

33. Në rast të helmimit nga monoksidi i karbonit, trajtimi fillestar përfshin:

- a. administrimi i oksigjenit 100%
- b. largimi nga burimi i ekspozimit
- c. dhënia e diuretikëve të ansës
- d. vlerësimi dhe sigurimi i rrugëve të frymëmarrjes
- e. vendosja në dietë hiposodike

34. Cila masë aplikohet te pacienti me ascit masiv?

- a. monitorimi për dispne dhe përgatitja për paracentezë sipas urdhrit
- b. kompresim i fortë abdominal
- c. pozicion semi-Fowler për lehtësim respirator
- d. ulje e menjëhershme e kokës poshtë
- e. matja e perimetrit abdominal dhe peshës ditore

35. Dispnea vlerësohet me:

- a. vetëm BMI
- b. frekuenca respiratore
- c. përdorimi i muskujve aksesorë dhe puna respiratore
- d. saturimi i oksigjenit
- e. vetëm perimetri i belit

36. Pse merret urino-kultura para antibiotikut?

- a. për të identifikuar mikroorganizmin shkaktar
- b. për të përcaktuar ndjeshmërinë ndaj antibiotikëve
- c. për të rritur numrin e leukociteve
- d. për të ulur menjëherë temperaturën
- e. për të marrë rezultat kulturor të saktë

37. Cila ndërhyrje aplikohet në edemë periferike?

- a. shtrim i sheshtë pa lëvizje për ditë të tëra
- b. ngritja e gjymtyrëve
- c. kompresioni/elastika sipas urdhrit
- d. masazh i fortë mbi venat e dhimbshme
- e. kujdesi për lëkurën dhe vlerësimi i edemës

38. Cila vlerë elektrolitike monitorohet te pacientët në diuretikë?

- a. amilaza
- b. glukoza postprandiale
- c. bilirubina direkte
- d. troponina
- e. kaliumi

39. Hiperkalemia emergjente manifestohet me:

- a. hiperrefleksi i theksuar
- b. aritmi kardiake
- c. dobësi muskulore
- d. parestezi (mpirje)
- e. valë T të mprehta në EKG

40. Cila ndërhyrje bëhet në alergjitë nga medikamentet IV?

- a. ndërprerja e menjëhershme e infuzionit
- b. njoftimi urgjent dhe përgatitja për trajtim antialergjik
- c. rritja e shpejtësisë së infuzionit
- d. aplikimi i nxehtësisë në venë
- e. mbajtja e linjës me NaCl 0.9% sipas nevojës

41. Në pneumoni bakteriale, cilës shenjë klinike infermieri duhet t'i kushtojë vëmendje për përkeqësim respirator?

- a. ulja e SpO₂
- b. prurit lokal në krah
- c. ulja e oreksit pa dispne
- d. rritja e përdorimit të muskujve aksesorë ose cianoza
- e. rritja e frekuencës respiratore

42. Tek pacienti me BPOC, pozicioni më i përshtatshëm për lehtësimin e frymëmarrjes është:

- a. shtrirja plotësisht në supin
- b. pozicioni Fowler i lartë
- c. pozicion ventral i detyruar pa mbështetje
- d. pozicioni tripod/ulur i përkulur përpara
- e. Trendelenburg

43. Cili është prioriteti infermieror pas administrimit IV të furosemidit?

- a. matja e perimetrit kranial
- b. monitorimi i presionit arterial
- c. vlerësimi i mprehtësisë vizuale
- d. monitorimi i diurezës
- e. monitorimi i kaliumit dhe elektroliteve

44. Kur një pacient me insuficiencë kardiake paraqet edemë të theksuar, infermieri duhet të:

- a. dhënia e ujit pa kufi
- b. ndalimi i plotë i lëvizjes pa arsye
- c. pesha ditore
- d. respektimi i kufizimit të lëngjeve/kripës sipas urdhrit
- e. ngritja e gjymtyrëve dhe monitorimi i edemës

45. Tek pacienti me hipoglicemi, masa e parë infermierore është:

- a. kufizimi i lëngjeve
- b. vendosja e akullit në qafë
- c. matja e glukozës kapilare sa më shpejt
- d. administrimi i karbohidrateve me veprim të shpejtë nëse pacienti është i vetëdijshëm
- e. injeksion IM të heparinës

46. Cila është shenja paralajmëruese e sepsis e cila kërkon veprim urgjent infermieror?

- a. konstipacioni kronik
- b. takipnea ose laktat i rritur
- c. rritja e refleksit plantar
- d. ndryshimi i gjendjes mendore
- e. hipotensioni

47. Tek pacientet me preeklampsi, infermieri duhet të monitorojë rregullisht:

- a. diurezën dhe proteinurinë
- b. vetëm temperaturën e lëkurës
- c. refleksat, dhimbjen e kokës dhe çrregullimet vizuale
- d. presionin arterial
- e. vetëm perimetrin torakal

48. Cila është ndërhyrja kryesore infermierore pas operacionit të tiroides?

- a. monitorimin e rrugëve të frymëmarrjes
- b. monitorimin për hipokalcemi dhe tetani
- c. dhënien e ushqimeve të forta menjëherë
- d. vlerësimin e hematomës/hemorragjisë në qafë
- e. pozicionimin në Trendelenburg

49. Në astmë akute, infermieri duhet të administrojë si terapi të parë:

- a. antikoagulant oral
- b. beta2-agonist inhalator me veprim të shpejtë (p.sh., salbutamol)
- c. diuretik tiazidik
- d. digoksinë
- e. insulinë IV

50. Cili është një komplikacion i zakonshëm i kanulës venoze periferike?

- a. ulçera peptike
- b. infiltrimi i infuzionit
- c. okluzioni i kanulës
- d. flebiti
- e. glaukoma akute

51. Për një pacient me ketoacidozë diabetike, prioriteti infermieror është:

- a. monitorimi i kaliumit dhe fillimi i insulinës sipas protokollit
- b. reanimimi me lëngje IV
- c. kufizimi absolut i lëngjeve
- d. ndalimi i çdo kontrolli laboratorik
- e. monitorimi i glukozës dhe ketoneve

52. Cili është rreziku kryesor pas frakturës së legenit?

- a. glaukoma
- b. shoku hipovolemik
- c. hipotiroidizmi
- d. embolia gazoze nga veshi
- e. hemorragjia masive

53. Tek pacienti me meningjit bakterial, infermieri duhet të vendosë prioritet:

- a. mobilizimi pa mbështetje
- b. administrimi në kohë i antibiotikëve sipas urdhrit
- c. izolimi dhe masat e mbrojtjes
- d. monitorimi neurologjik dhe i rrugëve të frymëmarrjes
- e. ushqyerja orale e detyruar

54. Një person peshon 70 kg dhe është 1.75 m i gjatë. Cili është BMI i përafërt?

- a. rreth 22.9 kg/m²
- b. rreth 35.2 kg/m²
- c. rreth 31.5 kg/m²
- d. rreth 18.0 kg/m²
- e. rreth 27.8 kg/m²

55. Tek pacienti me tamponadë kardiake, prioritetet e menjëhershme infermierore janë:

- a. njoftimi urgjent i ekipit mjekësor
- b. përgatitja për ekokardiografi urgjente ose perikardiocentezë
- c. mobilizimi i hershëm i pacientit
- d. kufizimi i monitorimit hemodinamik për të ulur stresin
- e. dhënia e lëngjeve orale pa vlerësim të mëtejshëm

56. Në administrimin e morfinës, infermieri duhet të monitorojë sidomos:

- a. frekuencën respiratore
- b. ngjyrën e iris-it
- c. nivelin e sedacionit
- d. perimetrin abdominal
- e. presionin arterial dhe saturimin

57. Tek pacienti me dështim renal akut prioriteti është:

- a. monitorimi i diurezës orare
- b. balanca e lëngjeve dhe elektroliteve
- c. vëzhgimi për hiperkalemi
- d. ndërprerja e çdo vlerësimi të urinës
- e. rritja e marrjes së kaliumit

58. Rrjedhja e pastër e lëngut nga veshi pas traumes mund të sugjerojë:

- a. trombozë venoze
- b. frakturë bazale të kafkës
- c. otit media seroz
- d. perforim intestinal
- e. rrjedhje të lëngut cerebrospinal

59. Cila është shenja e flebiti në vendin e kanulës?

- a. ngrohtësi/indurim lokal
- b. skuqje përgjatë venës
- c. hipotermi qendrore
- d. zbardhje e sklerave
- e. dhimbje dhe ndjeshmëri lokale

60. Tek pacienti me goditje cerebrale (ICV) prioritet është:

- a. vlerësimi neurologjik i shpejtë
- b. sigurimi i rrugëve të frymëmarrjes
- c. përcaktimi i kohës së fillimit të simptomave
- d. ushqyerja e menjëhershme orale
- e. ambulimi pa mbikëqyrje

61. Tek pacienti me ulçerë të presionit, masa kryesore infermierore është:

- a. masazh i fortë mbi ulçerë
- b. qëndrimi i pandryshuar në një anë
- c. ripozicionimi i rregullt
- d. kujdesi për lëkurën dhe lagështinë
- e. ulja e presionit me sipërfaqe mbështetëse

62. Tek një infarkt akut, dhimbja e krahavorit trajtohet me:

- a. morfina sipas protokollit
- b. nitroglicerina sipas urdhrit
- c. laksativ stimulues
- d. oksigjeni nëse pacienti është hipoksik
- e. antibiotik oral empiric

63. Cila është shenja që mund të tregojë aritmi kardiake?

- a. rritja e diurezës
- b. marramendja ose sinkopa
- c. hiperaktiviteti
- d. palpitacionet
- e. pulsi i parregullt

64. Infermieri duhet të ndërpresë transfuzionin e gjakut menjëherë kur:

- a. dispne
- b. uri e shtuar
- c. ethe ose të dridhura
- d. gojë e thatë pa shenja tjera
- e. dhimbje mesi/hipotension/urtikarie

65. Në ORL, epistaksa anteriore trajtohet zakonisht me:

- a. tamponadë/anterior nasal packing nëse vazhdon
- b. shtrirje plotësisht në shpinë
- c. vazokonstriktor lokal sipas urdhrit
- d. fryrje e hundës me forcë
- e. kompresion direkt i hundës

66. Tek pacienti me apendicit akut, infermieri duhet të shmangë:

- a. përgatitjen për ndërhyrje
- b. dhënien e laksativëve
- c. ushqimin dhe lëngjet orale pa urdhër
- d. vëzhgimin e dhimbjes
- e. aplikimin e nxehtësisë në abdomen

67. Tek pacienti me insuficiencë hepatike, shenja kritike është:

- a. rritja e refleksit patelar si gjetje e vetme
- b. ikteri progresiv
- c. gjakderdhja për shkak të koagulopatisë
- d. encefalopatia hepatike me ndryshim të vetëdijes
- e. hiperglicemia e izoluar

68. Në cilën arterie matet pulsi në raste emergjente kur pulsi periferik nuk është i ndjeshëm?

- a. arteria radiale
- b. arteria temporale sipërfaqësore
- c. arteria karotide
- d. arteria dorsalis pedis
- e. arteria retinale

69. Në psikiatri, tek pacienti me agjitacion, masa e parë është:

- a. vlerësimi i shkaktarëve të agjitacionit
- b. argumentimi konfrontues
- c. prekja fizike pa paralajmërim
- d. qasje e qetë dhe de-eskalim verbal
- e. sigurimi i mjedisit dhe i sigurisë

70. Tek pacienti me sëmundje infektive me izolim kontakti, infermieri duhet të përdorë:

- a. doreza
- b. higjienë e duarve dhe pajisje të dedikuara
- c. mantel mbrojtës
- d. kapelë sterile kirurgjikale si kërkesë bazë
- e. respirator N95 si masa e vetme

71. Shenjë e hershme e shokut hipovolemik është:

- a. lëkurë e ftohtë dhe e lagësht
- b. takikardi
- c. rritje e pulsit të fortë periferik
- d. bradikardi e theksuar
- e. ankth ose shqetësim i hershëm

72. Tek një pacient me tub nazogastrik, vlerësimi më i rëndësishëm është:

- a. vlerësimi i aspiratit/pH sipas protokollit
- b. dhënia e lëngjeve pa verifikim
- c. ngrohja e tubit me flakë
- d. verifikimi i vendosjes së tubit
- e. kontrolli i gjatësisë së jashtme

73. Tek frakturat e hapura, infermieri duhet të:

- a. reponimi forcërisht i kockës
- b. mbulimi me garzë sterile
- c. imobilizimi i gjymtyrës
- d. kontrolli i gjakderdhjes
- e. larja me solucion irritues

74. Tek kriza hipertensive, prioriteti infermieror është:

- a. sigurimi i aksesit IV dhe barnave sipas urdhrit
- b. monitorimi i presionit arterial dhe statusit neurologjik
- c. vlerësimi për dëmtim të organeve target
- d. ulja e menjëhershme me ushtrime fizike
- e. dhënia e shumë lëngjeve hipotonike pa urdhër

75. Cila metodë përdoret shpesh për matjen e temperaturës tek foshnjat?

- a. palmare
- b. intraokulare
- c. arteriale invasive
- d. ezofageale
- e. aksilare

76. Tek foshnjat me bronkiolit, masa infermierore kryesore është:

- a. mbajtja e hidratimit
- b. aplikimi rutinë i antidiarreikëve
- c. pastrimi/suksionimi i sekrecioneve nazale
- d. monitorimi i frymëmarrjes dhe SpO2
- e. ushqyerja me porcione të mëdha të detyruara

77. Në infarkt cerebral, koha “golden hour” nënkupton:

- a. fillimin e fizioterapisë para ABC-së
- b. pritjen 24 orë para vlerësimit neurologjik
- c. fillimin e vlerësimit dhe trajtimit sa më shpejt, idealisht brenda orës së parë
- d. vlerësimin vetëm pas CT-së së vonuar
- e. ruajtjen e indit cerebral me veprim të menjëhershëm

78. Shenjë tipike e dështimit të djathtë të zemrës është:

- a. edemë periferike
- b. hepatomegali ose kongestion venoz
- c. distension i venave jugulare
- d. hemoptizi e freskët
- e. ortopne si gjetja e vetme

79. Për parandalimin e trombozës pas operacionit, infermieri duhet të:

- a. dehidratimi i qëllimshëm
- b. profilaksia mekanike/farmakologjike sipas urdhrit
- c. mobilizimi i hershëm
- d. ushtrimet e këmbëve
- e. pozicioni i ulur pa lëvizje gjithë ditën

80. Tek pacientët me COVID-19 hipoksik, pozicioni më efektiv është:

- a. supin i sheshtë
- b. pozicioni pron (prone)
- c. Trendelenburg
- d. pozicion genupektoral
- e. lateral i majtë i detyruar

81. Tek pacienti me fraktura të brinjëve, rreziku kryesor është:

- a. hematuri masive
- b. hipoventilim dhe atelektazë nga dhimbja
- c. pneumotoraks ose kompromis respirator
- d. hipoglicemi e menjëhershme
- e. ileus paralitik

82. Infermieri duhet të ndërpresë heparinën menjëherë nëse shfaqet:

- a. gjakderdhja aktive
- b. hematuri ose melena
- c. etje e lehtë e këmbëve
- d. rënie e trombociteve/HIT e dyshuar
- e. thatësi e lëkurës

83. Tek pacienti me bronkopneumoni, prioritet është:

- a. kufizimi absolut i kollitjes
- b. monitorimi i RR dhe SpO₂
- c. ruajtja e oksigjenimit
- d. shtrirja pa ndryshim pozicioni
- e. administrimi i terapisë sipas urdhrit dhe lehtësimi i sekrecioneve

84. Tek pacienti me fistulë AV për dializë, kontrolli më i rëndësishëm është:

- a. prania e thrill-it
- b. dëgjimi i bruit-it
- c. matja e presionit mbi fistulë
- d. ruajtja e perfuzionit distal të krahut
- e. venipunkcioni në të njëjtin krah

85. Tek pacienti me anemi të rëndë, shenja më e rëndësishme është:

- a. zbehje e theksuar me lodhje të rëndë
- b. takikardi e shprehur
- c. hipertermia e izoluar
- d. rritje e peshës me edemë limfatike
- e. dispne në pushim ose në sforcim minimal

86. Tek pacienti me infektion të traktit urinar, simptoma kryesore është:

- a. urgjencë urinare
- b. ikter
- c. djegie gjatë urinimit (dizuri)
- d. frekuencë e shtuar urinare
- e. bradikardi sinusale

87. Në IR (insuficiencë respiratore), infermieri duhet të:

- a. japë laksativ stimulues
- b. kufizojë lëvizjen e gjuhës
- c. administrojë oksigjen sipas nevojës
- d. sigurojë rrugët e frymëmarrjes
- e. monitorojë SpO₂, gazrat arteriale dhe shenjat vitale

88. Tek plagët kirurgjikale, eksudimi i tepërt mund të tregojë:

- a. ulje të temperaturës qendrore
- b. përmirësim të menjëhershëm të shërimit
- c. hidrim të mirë sistemik
- d. dehishencë ose komplikim lokal
- e. infektion të plagës

89. Tek pacienti me insuficiencë renale kronike, dieta duhet të ketë:

- a. proteinë të kontrolluar sipas rekomandimit
- b. kufizim të kaliumit/fosforit sipas fazës
- c. sasi të pakufizuar kripe
- d. kufizim të natriumit
- e. sasi të lartë bananesh dhe arrash pa kufi

90. Tek një pacient me sëmundje infektive me izolim ajror, duhet të përdoret:

- a. dhomë me presion negativ
- b. respirator N95/FFP2
- c. kufizim i transportit dhe maskë për pacientin kur transportohet
- d. vetëm syze mbrojtëse
- e. vetëm doreza pa respirator

91. Tek pacienti me frakturë femuri, prioritet është:

- a. vlerësimi për gjakderdhje dhe shok
- b. kontrolli i dhimbjes
- c. imobilizimi i gjymtyrës
- d. ecja e menjëhershme pa ndihmë
- e. masazh i fortë mbi vendin e frakturës

92. Shenjë e dekompensimit kardiak është:

- a. dispne dhe intolerancë në aktivitet
- b. edemë/rritje peshe nga retencioni i lëngjeve
- c. krepitacione pulmonare
- d. hiperrefleksi i izoluar
- e. rritje e mprehtësisë vizuale

93. Tek pacienti me ulçerë peptike, infermieri duhet të:

- a. dhënia e alkoolit për oreks
- b. edukimi për dietë dhe terapi sipas urdhrit
- c. shmangia e NSAID dhe irritantëve
- d. monitorimi për gjakderdhje gastrointestinale
- e. aplikimi i nxehtësisë direkte në epigastër pa urdhër

94. Tek pacienti i intubuar, detyra infermierore e përditshme është:

- a. heqja e tubit për ushqyerje
- b. shmangia e çdo mobilizimi
- c. suksionimi sipas nevojës dhe higjiena respiratore
- d. kontrolli i pozicionit të tubit dhe presionit të manshetës
- e. kujdesi oral i përditshëm

95. Tek fëmijët me ethe, infermieri duhet të:

- a. dhënia e aspirinës rutinë çdo foshnje
- b. mbështjellja me batanije të trasha pavarësisht temperaturës
- c. vlerësimi i temperaturës dhe gjendjes së përgjithshme
- d. mbajtja e hidratimit dhe veshje të lehta
- e. administrimi i antipiretikëve sipas urdhrit

96. Tek pacientët me obezitet në kirurgji, rreziku më i madh është:

- a. komplikacionet respiratore postoperative
- b. ulje e përhershme e acuitetit vizual
- c. otit media akut
- d. infeksioni i plagës
- e. tromboza venoze e thellë

97. Tek pacienti me dështim të ventrikulit të majtë, shenja tipike është:

- a. dispne
- b. krepitacione/pulmonar edemë
- c. skuqje e lokalizuar e lëkurës
- d. ortopne
- e. ikter i hershëm

98. Tek pacienti me alergji të rëndë (anafilaksi), veprimi i parë është:

- a. beta-blokues oral
- b. antacid oral
- c. digoksinë IV
- d. heparinë SC
- e. adrenalina IM e menjëhershme

99. Në administrimin e potasiumit IV, infermieri duhet të sigurohet që:

- a. ekziston diurezë adekuate
- b. nuk jepet kurrë IV push
- c. jepet gjithmonë pa monitorim EKG
- d. solucioni është i holluar dhe administrohet me pompë
- e. infuzohet më shpejt sa më shumë dhimbje

100. Tek pacienti me peritonit, shenja karakteristike është:

- a. abdomen i fortë si dërrasë
- b. ndjeshmëri me rebound
- c. bradikardi pa dhimbje
- d. rritje e oreksit
- e. dhimbje e fortë abdominale me mbrojtje muskulare

101. Faza e parë e procesit infermieror është:

- a. edukimi shëndetësor
- b. planifikimi
- c. delegimi
- d. implementimi
- e. vlerësimi infermieror

102. Në fazën e diagnostikimit infermieror, infermieri:

- a. analizon të dhënat e mbledhura
- b. identifikon problemet dhe reagimet e pacientit
- c. formulon diagnozën infermiore
- d. vendos diagnozën mjekësore
- e. përshkruan medikamente

103. Objektivat infermierorë duhet të jenë:

- a. specifike
- b. të matshëm
- c. të përgjithshëm dhe pa afat
- d. të paqartë
- e. realistë dhe me afat kohor

104. Infermieri vlerëson efektin e ndërhyrjeve në fazën e:

- a. vlerësimit
- b. delegimit
- c. planifikimit
- d. diagnostikimit mjekësor
- e. sterilizimit

105. Shembull i diagnozës infermierore është:

- a. pneumoni lobare
- b. apendicit akut
- c. dhimbje akute e lidhur me incizionin kirurgjikal
- d. hipertension arterial esencial
- e. insuficiencë renale kronike

106. Tek pacienti me COPD, diagnoza infermierore më e shpeshtë është:

- a. rrezik për kapsllëk
- b. komunikim verbal i përmirësuar
- c. hipertermi
- d. tolerancë e rritur ndaj aktivitetit
- e. shkëmbim i dëmtuar i gazrave

107. Në fazën e planifikimit, infermieri duhet të:

- a. të përcaktojë prioritetet
- b. të zgjedhë ndërhyrjet infermierore
- c. të anulojë vlerësimin fillestar
- d. të vendosë qëllime dhe rezultate të pritshme
- e. të përshkruajë diagnozën kirurgjikale

108. Cili prej tyre konsiderohet ndërhyrje infermierore e pavarur?

- a. vendosja e kateterit qendror
- b. përgatitja e anestezisë së përgjithshme
- c. administrimi i antibiotikut IV
- d. transfuzioni i gjakut
- e. edukimi për frymëmarrje me buzë të mbledhura

109. Çfarë është Body Mass Index (BMI)?

- a. perimetri i belit i vetëm
- b. niveli i glukozës në gjak
- c. një tregues i raportit mes peshës trupore dhe gjatësisë
- d. indeksi peshë/gjatësi²
- e. presioni mesatar arterial

110. Me termin "outcome" në procesin infermieror nënkuptohet:

- a. metodën e sterilizimit
- b. ndryshimin e synuar pas ndërhyrjeve
- c. diagnozën mjekësore finale
- d. rezultatin e pritshëm të matshëm
- e. listën e barnave

111. Tek pacientët me ulçerë të presionit, diagnoza infermierore më e përshtatshme është:

- a. integritet i dëmtuar i lëkurës
- b. diurezë e shtuar
- c. rrezik për hipoglicemi
- d. termorregullim efektiv
- e. komunikim verbal i paprekur

112. Masë kryesore për parandalimin e aspirimit tek pacientët me sondë NG është:

- a. dhënia e volumeve të mëdha me shpejtësi
- b. shtrirja e sheshtë pas ushqyerjes
- c. verifikimi i pozicionit të sondës para ushqyerjes
- d. ngritja e kokës së krevatit 30-45°
- e. heqja e kontrollit të aspiratit

113. Tek pacienti me goditje cerebrale, diagnoza nfermieror është:

- a. ekuilibër ushqimor optimal pa deficit
- b. rrezik për hipertermi malinje
- c. rritje e integritetit të lëkurës
- d. rrezik për aspirim
- e. mobilitet fizik i dëmtuar

114. Shenjë e hershme e infeksionit të plagës kirurgjikale është:

- a. skuqje lokale
- b. ulje e hematokritit si gjetja e vetme
- c. rritje e dhimbjes në plagë
- d. ngrohtësi dhe ndjeshmëri
- e. bradikardi sinusale

115. Cura e plagës bëhet me teknikë:

- a. radiologjike
- b. sterile/aseptike
- c. kontaminuese
- d. intravenoze
- e. jo sterile me dorëza të zakonshme

116. Tek dehidratimi, shenja më e besueshme është:

- a. hiperaktiviteti
- b. rritja e pështymës
- c. oliguria
- d. hipergjuhësia
- e. rritja e reflekseve

117. Tek pacienti me gastrostomë, infermieri duhet të:

- a. ta lërë qesen e ushqimit në temperaturë dhome gjithë ditën
- b. ta shpëlajë tubin sipas protokollit
- c. të kontrollojë vendosjen dhe kalueshmërinë e tubit
- d. të mbajë të pastër dhe të thatë zonën përreth stomës
- e. të japë ushqim pa verifikuar tolerancën

118. Në dështim kardiak, marrja e peshës ditore ndihmon në:

- a. diagnostikimin e anemisë
- b. vlerësimin e mprehtësisë vizuale
- c. vlerësimin e funksionit të tiroides
- d. matjen e densitetit kockor
- e. zbulimin e hershëm të mbajtjes së lëngjeve

119. Cili është dallimi në mes të diagnozes infermierore dhe asaj mjekësore?

- a. diagnoza infermierore udhëheq ndërhyrjet infermierore
- b. diagnoza infermierore fokusohet në reagimet e pacientit
- c. diagnoza infermierore zëvendëson diagnozën mjekësore
- d. diagnoza mjekësore fokusohet në sëmundjen/procesin patologjik
- e. diagnoza mjekësore përcakton kujdesin bazik të lëkurës

120. Cila nga më poshtë është një komplikim i kateterit urinar?

- a. glaukoma
- b. pneumotoraks
- c. traumë/iritim uretral
- d. obstrukcion i kateterit
- e. infeksion urinar i lidhur me kateterin

121. Cila është një shenjë tipike e leukemisë?

- a. zbehje dhe lodhje
- b. infeksione të shpeshta
- c. hipertension ortostatik
- d. hiperaktivitet me eufori
- e. peteqi ose gjakderdhje e lehtë

122. Tek hiperglicemia emergjente, prioritet është:

- a. kufizimi absolut i lëngjeve
- b. reanimimi me lëngje
- c. insulina sipas protokollit dhe monitorimi i kaliumit
- d. monitorimi i glukozës dhe ketoneve
- e. ndalimi i kontrollit të glukozës

123. Tek pacientët me demencë, ndërhyrje efektive është:

- a. mjedis i sigurt me orientim të butë
- b. ndryshimi i vazhdueshëm i orarit
- c. konfrontimi i ashpër për gabimet e kujtesës
- d. mbajtja e rutinës së përditshme
- e. udhëzime të thjeshta dhe të qarta

124. Cili është rreziku më i madh i imobilizimit të gjatë?

- a. pneumonia nga staza
- b. ulçerat e presionit
- c. tromboza venoze e thellë
- d. rritja e masës muskulore
- e. përmirësimi i menjëhershëm i forcës

125. Në dhimbjet postoperative, infermieri duhet të vlerësojë:

- a. lokalizimin dhe karakterin e saj
- b. intensitetin e dhimbjes
- c. faktorët që e lehtësojnë ose e përkeqësojnë
- d. vetëm ngjyrën e syve
- e. vetëm grupin e gjakut

126. Tek pacientët me HIV, masë e rëndësishme infermierore është:

- a. edukimi për aderencë në terapi dhe vetëkujdes
- b. monitorimi për infeksione oportuniste
- c. izolimi i detyrueshëm ajror në çdo rast
- d. zbatimi i masave standarde të mbrojtjes
- e. ndalimi i çdo kontakti social

127. Tek pneumonia, shenja e përkeqësimit është:

- a. temperaturë normale
- b. rritja e frekuencës respiratore
- c. ulja e saturimit të oksigjenit
- d. cianoza ose konfuzioni i ri
- e. rritja e oreksit

128. Administrimi i insulinës bëhet zakonisht në:

- a. intratekal
- b. intradermal
- c. në indin nënlëkuror (subkutan)
- d. intraarterial
- e. intramuskular thellë

129. Shenjë e hershme e hipokalcemisë është:

- a. polidipsi
- b. parestezi periorale ose në gishta
- c. ngërçe ose spazma muskulore
- d. shenja Chvostek/Trousseau
- e. hiperrefleksi pupilar i izoluar

130. Tek pacientët me dializë, ndalohe matja e presionit në:

- a. krahun me kanulë periferike të vogël
- b. këmbën e djathtë gjithmonë
- c. krahun dominues të shëndoshë
- d. parakrahun pa fistulë
- e. krahun me fistulë AV

131. Tek pacientët që marrin warfarin, infermieri duhet të monitorojë:

- a. shenjat e gjakderdhjes
- b. INR/PT
- c. amilaza serike
- d. niveli i troponinës
- e. ndërveprimet me dietën dhe barnat

132. Tek pacienti me frakturë të mbyllur, shenja e kompartmentit është:

- a. dhimbje në shtrirje pasive
- b. dhimbje e fortë joproportionale
- c. miozë e izoluar
- d. rritje e oreksit
- e. parestezi dhe tension i kompartmentit

133. Shenjë tipike e hipotiroidizmit është:

- a. diare kronike
- b. intolerancë ndaj të ftohtit
- c. kapsllëk ose shtim në peshë
- d. lodhje dhe përgjumje
- e. takikardi dhe humbje peshe

134. Tek pacientët me infeksione urinare, ndërhyrje e rëndësishme është:

- a. reduktimi i çdo marrjeje lëngu pa arsye
- b. mbajtja e urinës për kohë të gjatë
- c. rritja e marrjes së lëngjeve nëse nuk kundërintikohet
- d. administrimi korrekt i antibiotikut sipas urdhrat
- e. higjiena perineale korrekte

135. Në plagët që kullon shumë, infermieri duhet të:

- a. të vlerësojë sasinë, ngjyrën dhe erën e drenazhit
- b. ta ekspozojë plagën vazhdimisht në ajër pa indikacion
- c. të forcojë/ndërrojë fashën me teknikë të pastër ose sterile sipas rastit
- d. të raportojë rritjen e papritur të kullimit
- e. ta mbyllë plagën me leukoplast pa vlerësim

136. Tek dështimi respirator, shenja kritike është:

- a. alterim i vetëdijes
- b. hipoksemi e rëndë/cianoze
- c. oreks i shtuar
- d. përdorim i theksuar i muskujve aksesorë ose lodhje respiratore
- e. bradikardi fiziologjike gjatë gjumit

137. Në pancreatitis akut, pacienti paraqet:

- a. uritje të shtuar pa dhimbje
- b. nauze dhe të vjella
- c. rritje të amilazës/lipazës
- d. hemiplegji akute
- e. dhimbje epigastrike që rrezaton në shpinë

138. Tek pacienti me kolostomë, kujdesi bazë është:

- a. vendosja e duhur e qeses dhe monitorimi i output-it
- b. masazhimi i fortë i mukozës
- c. mbrojtja e lëkurës peristomale
- d. vlerësimi i ngjyrës dhe edemës së stomës
- e. matja e presionit në stomë

139. Tek pacienti i pavetëdijshëm, prioriteti është:

- a. pozicionimi për parandalimin e aspirimit nëse nuk ka traumë të shtyllës
- b. ambulimi i shpejtë
- c. monitorimi i frymëmarrjes dhe qarkullimit
- d. sigurimi i rrugëve të frymëmarrjes
- e. ushqyerja orale e menjëhershme

140. Tek alergjia e rëndë, shenja kritike është:

- a. dispne e rëndë
- b. hipotension/anamneza e anafilaksisë
- c. konstipacion i lehtë
- d. oreks i rritur
- e. stridor ose edemë e rrugëve të frymëmarrjes

141. Tek pacienti me sepsë, prioritet është:

- a. njoftimi urgjent dhe përgatitja për antibiotikë/kultura sipas protokollit
- b. sigurimi i ABC
- c. dhënia e ushqimit oral para stabilizimit
- d. fillimi i lëngjeve dhe monitorimi hemodinamik
- e. ulja e monitorimit të temperaturës

142. Shenjë e dehidratimit të rëndë është:

- a. sy të fundosur dhe mukozë shumë të thata
- b. rritje e turgorit të lëkurës
- c. hipotension i theksuar
- d. hipersalivim
- e. oliguri/anuri

143. Tek pacienti me dëm neurologjik, shenja kritike është:

- a. pupila të pabarabarta
- b. ulja e GCS
- c. deficite të reja neurologjike ose kriza
- d. rritje e oreksit
- e. rritje e flokëve

144. Tek krizë hipertensive, shfaqet:

- a. erupsion i lokalizuar në krah
- b. çrregullime të shikimit
- c. dhimbje gjoksi ose deficit neurologjik
- d. dhimbje koke të forta
- e. hipotermi e thellë

145. Tek pacienti me aritmi të rënda, infermieri monitoron:

- a. ritmin në EKG
- b. perimetrin abdominal
- c. gjatësinë e thonjve
- d. nivelin e vetëdijes/sinkopën
- e. presionin arterial dhe perfuzionin

146. Tek një pacient me plagë të ndotur, dezinfektimi bëhet:

- a. nga zona më pak e kontaminuar drejt asaj më të kontaminuar
- b. me prekjen e drejtpërdrejtë të plagës me dorë
- c. nga lëkura përreth drejt qendrës së plagës së ndotur me të njëjtën garzë
- d. me lëvizje njëkahëshe dhe material të ri për çdo kalim
- e. spërkatje e përsëritur pa rend

147. Tek pacienti me djegie të shkallës II, shfaqet:

- a. fluska
- b. cianozë e gjuhës
- c. nekrozë e thellë e karbonizuar pa dhimbje
- d. skuqje me sipërfaqe të lagësht
- e. dhimbje

148. Tek helmimi me CO₂ shfaqet:

- a. konfuzion ose përgjumje
- b. dhimbje koke
- c. dispne/hiperkapni
- d. pupila fikse bilaterale pa frymëmarrje
- e. hipoglicemi e menjëhershme

149. Tek pacienti me ethe, infermieri duhet të:

- a. të administrojë antipiretikë sipas urdhrit dhe masa fizike të lehta
- b. ta lërë pa lëngje
- c. të sigurojë hidratim
- d. ta mbulojë me batanije të trasha pavarësisht temperaturës
- e. të monitorojë temperaturën dhe shenjat vitale

150. Tek pacienti me frakturë vertebrale, pozicioni duhet të jetë:

- a. fleksion i qafës për komoditet
- b. ulje e menjëhershme në karrige
- c. imobilizim në aks neutral
- d. log-roll për kthime
- e. sipërfaqe e fortë dhe mbështetje e kolonës

151. Tek pacienti me emboli pulmonare, shenja tipike është:

- a. hemoptizi si e vetmja shenjë e nevojshme
- b. bradikardi fiziologjike
- c. takikardi dhe hipoksemi
- d. dhimbje torakale pleuritike
- e. dispne e papritur

152. Tek pacienti me hipotermi, infermieri duhet të:

- a. ngrohje ekstreme shumë e shpejtë pa monitorim
- b. ngrohje graduale
- c. mbulim me batanije të ngrohta/solucione të ngrohta sipas protokollit
- d. fërkim i fuqishëm i lëkurës së ftohtë
- e. monitorim i ritmit kardiak

153. Të vjellat e gjakut (hematemezë) janë shenjë e:

- a. gjakderdhjes së traktit gastrointestinal të sipërm
- b. gjakderdhjes nga trakti urinar
- c. otitit media
- d. meningjitit bakterial
- e. epistaksës posterior

154. Tek pacientët me artritis reumatoid, kujdes infermieror është:

- a. balancimi i pushimit me aktivitetin
- b. ushtrimet e rënda në fazë akute
- c. mbrojtja e nyjeve dhe ruajtja e ROM
- d. imobilizimi i plotë afatgjatë pa arsye
- e. menaxhimi i dhimbjes dhe inflamacionit

155. Parandalimi i ulçerës së presionit përfshin:

- a. rritje e presionit mbi prominencat kockore
- b. ripozicionim i rregullt
- c. ushqyerje dhe hidratim adekuat
- d. inspektim i lëkurës
- e. masazh i zonave të skuqura të vazhdueshme

156. Tek pacientët me stomë, problemi i zakonshëm është:

- a. rrjedhja e qeses
- b. iritimi i lëkurës peristomale
- c. frakturë e femurit
- d. glaukoma akute
- e. gazra/erë dhe menaxhim i vështirë i output-it

157. Tek pacienti me aritmi të rënda, rreziku më i madh është:

- a. arrest kardiak
- b. rritje e pigmentimit të lëkurës
- c. ulje e debitit kardiak
- d. sinkopë
- e. shtim i oreksit

158. Tek infeksionet streptokoksike të fytit, komplikim i mundshëm është:

- a. glomerulonefrit post-streptokoksik
- b. otit media si i vetmi komplikim serioz
- c. ethe reumatike
- d. absces peritonsilar
- e. hipertiroidizëm

159. Cili faktor mund të ndikojë në matjen e saktë të saturimit?

- a. gjatësia e flokëve
- b. llaku në thonj
- c. grupi i gjakut
- d. perfuzion i dobët periferik
- e. lëvizjet e pacientit ose të ftohtit e ekstremiteteve

160. Tek pacientët me stenoze karotide, shenja është:

- a. ikter i theksuar
- b. amaurosis fugax ose dobësi e përkohshme njëanësore
- c. episode të TIA-së
- d. hematemezë
- e. bruit karotid

161. Tek pacienti me parkinson, infermieri duhet të:

- a. të ndihmojë në lëvizje dhe ADL
- b. ta ushqejë shtrirë plotësisht
- c. të administrojë medikamentet në kohë dhe të lejojë kohë për aktivitet
- d. të zbatojë masa kundër rënies
- e. ta nxisë ecjen pa ndihmë në dysHEME të lagësht

162. Në rast të djegieve të rënda, cili është hapi i parë në menaxhimin emergjent?

- a. largimi nga burimi i djegies/ndalimi i procesit të djegies
- b. dhënia e ushqimit oral menjëherë
- c. aplikimi i pomadave të yndyrshme menjëherë në djegie të mëdha
- d. shpimi i flluskave në vendngjarje
- e. sigurimi i rrugëve të frymëmarrjes

163. Tek pacienti me ascit, ndërhyrja infermierore është:

- a. matja e peshës dhe perimetrit abdominal
- b. pozicion semi-Fowler
- c. monitorimi i dispnesë dhe edemës
- d. kompresim i barkut me fashë të ngushtë
- e. ngritje e këmbëve mbi kokë

164. Tek pacienti me hepatit, duhet të shmanget:

- a. hidrimi sipas tolerancës
- b. alkooli
- c. barnat hepatotoksike pa udhëzim
- d. ndarja e briskut ose furçës së dhëmbëve me të tjerët
- e. pushimi adekuat

165. Tek pacienti me astmë, shenja e përkeqësimit është:

- a. ulje e oreksit
- b. ulje e SpO2 dhe vështirësi në të folur
- c. përdorim i muskujve aksesorë
- d. wheezing në rritje ose "silent chest"
- e. rritje e diurezës

166. Tek pacientët me fraktura të hapura, masë e parë është:

- a. mbulim steril i plagës
- b. kontrolli i gjakderdhjes
- c. larje me alkool të përqendruar në thellësi
- d. imobilizim i gjymtyrës
- e. shtyrje e kockës brenda plagës

167. Tek pacienti me dështim renal, shenja e hiperkalemisë është:

- a. valë T të mprehta
- b. dobësi muskulore
- c. aritmi
- d. poliuri e theksuar
- e. hiperaktivitet

168. Çfarë duhet të bëjë infermieri nëse vëren infiltrim të infuzionit?

- a. të ndalojë infuzionin
- b. të vazhdojë vëzhgimin pa ndërhyrje
- c. të aplikojë kompresë sipas llojit të medikamentit/protokollit
- d. të heqë kanulën dhe të ngrejë gjymtyrën sipas nevojës
- e. të rrisë shpejtësinë e infuzionit

169. Tek pacienti me helmim ushqimor, shenja kryesore është:

- a. dhimbje/krampe abdominale
- b. diarre
- c. të vjella
- d. stridor
- e. paralizë faciale

170. Tek pacienti me hipertension, edukimi përfshin:

- a. ndërprerje e barnave kur ndihet mirë
- b. marrje e rregullt e barnave
- c. pirje e pakufizuar e alkoolit
- d. dietë me pak kripë
- e. aktivitet fizik, kontroll peshe dhe monitorim i TA

171. Kujdesi oral tek pacientët e intubuar parandalon:

- a. hipotireozën
- b. kataraktin
- c. kolonizimin oral me patogjenë
- d. pneumoninë e lidhur me ventilatorin
- e. frakturën vertebrale

172. Tek pacienti me mbipeshë, problem i shpeshtë post-operativ është:

- a. trombozë venoze e thellë
- b. otit media
- c. infeksion i plagës
- d. migrenë me aura
- e. atelektazë/komplikacione respiratore

173. Tek pacienti me gastrit, infermieri duhet të:

- a. të monitorojë për gjakderdhje gastrointestinale
- b. të vendosë kompresë të nxehtë direkte pa vlerësim
- c. të shmangë irritantët gastrikë
- d. të japë alkool për qetësim
- e. të administrojë terapi dhe dietë sipas urdhrit

174. Tek pacienti me pleurit, simptomë tipike është:

- a. kruarje e këmbës së majtë
- b. puls i ngadaltë sportiv
- c. frymëmarrje të cekët nga dhimbja
- d. dhimbje që përkeqësohet me frymëmarrje të thellë
- e. polidipsi

175. Tek pacientët me obstruksion intestinal, infermieri duhet të vlerësojë:

- a. distensionin abdominal
- b. ngjyrën e flokëve
- c. vetëm mprehtësinë vizuale
- d. të vjellat dhe aspiratin NG
- e. zhurmat intestinale dhe kalimin e gazrave

176. Tek pacientët me sëmundje kronike pulmonare, edukimi duhet të theksojë:

- a. teknikat e frymëmarrjes dhe ruajtjen e energjisë
- b. mospërdorimin e asnjë terapie
- c. përdorimin korrekt të inhalatorëve/oksigenit sipas udhëzimit
- d. izolimin social
- e. ndalimin e duhanit

177. Një pacient 65-vjeçar me sëmundje pulmonare obstruktive kronike (SPOK/COPD) paraqitet në repart me dispne, takikardi dhe saturim të oksigjenit 86% në ajër ambiental. Cili është veprimi më i përshtatshëm fillestar i infermierit?

- a. ta vendosë në pozicion Fowler të lartë
- b. të fillojë oksigjen me rrjedhje të ulët sipas protokollit për COPD dhe të monitorojë SpO₂
- c. ta shtrijë plotësisht në supin
- d. ta dërgojë në ecje për të "hapur mushkëritë"
- e. t'i japë menjëherë lëngje orale të ftohta

178. Si quhet gjendja kur frekuenca e pulsit është mbi 100 rrahje/min?

- a. takikardi
- b. aritmi sinusale
- c. bigemini
- d. bradikardi
- e. asistoli

179. Tek pacientët me kollë produktive, ndërhyrja e duhur është:

- a. shtrirja e pandryshuar gjithë ditën
- b. rritja e hidratimit nëse lejohet
- c. lehtësimi i nxjerrjes së sekrecioneve/postural drainage sipas nevojës
- d. shtypja e vazhdueshme e kollës pa indikacion
- e. inkurajimi i kollitjes efektive dhe frymëmarrjes së thellë

180. Cili është funksioni kryesor i qelizave të bardha të gjakut?

- a. transportimi kryesor i oksigjenit
- b. rregullimi i glukozës
- c. mbrojtja nga infeksionet
- d. pjesëmarrja në përgjigjen imune
- e. koagulimi i gjakut

181. Tek pacientët me kurim IV, shenjë e infiltrimit është:

- a. miozë
- b. ënjtje në vendin e infuzionit
- c. ftohtësi dhe zbardhje lokale
- d. rrjedhje e ngadalësuar dhe parehati
- e. rritje e temperaturës qendrore

182. Tek infarkti i miokardit, shenja tipike është:

- a. djersitje e ftohtë
- b. poliuri
- c. dispne ose nauze
- d. ikter
- e. dhimbje/shtypje torakale që mund të rrezatojë

183. Në apendicit akut, shfaqet:

- a. nauze/të vjella
- b. dhimbje në kuadrantin e poshtëm të djathtë
- c. hemoptizi
- d. ndjeshmëri me rebound ose ethe
- e. bradikardi sportive

184. Tek pacienti me gjakderdhje të brendshme, shenja është:

- a. zbehje dhe lëkurë e ftohtë/lagësht
- b. hiperaktivitet
- c. takikardi
- d. rritje e oreksit
- e. hipotension

185. Tek pacientët me frikë nga procedurat, infermieri duhet të:

- a. të lejojë pyetje dhe të dëgjojë shqetësimet
- b. të minimizojë frikën duke e tallur pacientin
- c. të mos japë asnjë informacion
- d. të ofrojë mbështetje emocionale
- e. të shpjegojë procedurën me qetësi

186. Tek pacientët me sëmundje neurologjike, rrezik i madh është:

- a. hipertermi malinje rutinë
- b. komplikime nga imobilizimi
- c. rrezik për aspirim
- d. forcë muskulore e rritur spontanisht
- e. rrezik për rënie

187. Tek pacientët me maskë oksigjeni, duhet të shmanget:

- a. përdorimi i produkteve të ndezshme afër oksigjenit
- b. kontrolli i rrjedhës së O₂
- c. pirja e duhanit/flakët e hapura
- d. higjiena orale
- e. heqja e maskës pa arsye kur kërkohet terapi

188. Tek dështimi i djathtë i zemrës, shfaqet:

- a. krepitacione pulmonare si e vetmja gjetje
- b. edemë periferike
- c. distension i venave jugulare
- d. kongestion hepatic/hepatomegali
- e. hipoglicemi

189. Tek pacientët me alergji ushqimore, edukimi duhet të përfshijë:

- a. ndërprerjen e konsultave mjekësore
- b. planin emergjent dhe përdorimin e adrenalinit nëse është përshkruar
- c. provimin "pak nga pak" të alergjenit në shtëpi
- d. shmangien e alergjenit specifik
- e. leximin e etiketave të ushqimit

190. Tek pacienti me hipotiroidizëm, shfaqet:

- a. intolerancë ndaj të ftohtit
- b. takikardi
- c. kapsllëk/shtim në peshë
- d. lodhje
- e. djersitje e tepërt

191. Tek pacientët me diabet, këmbët duhen kontrolluar:

- a. çdo ditë
- b. vetëm një herë në muaj
- c. vetëm kur ka dhimbje
- d. nuk ka nevojë nëse sheqeri është normal
- e. vetëm pas prerjes së thonjve

192. Tek pacienti me paralizë të gjymtyrës, infermieri duhet të:

- a. mbajtje e gjymtyrës së varur gjatë gjithë kohës
- b. ushtrime të amplitudës së lëvizjes
- c. masazh i fortë mbi zonat me spasticitet pa vlerësim
- d. pozicionim korrekt i gjymtyrës
- e. kujdes i lëkurës dhe parandalim i kontrakturave

193. Tek tubi endotrakeal, problemi më i madh është:

- a. obstrukcioni me sekrecione
- b. hipertermi nga ventilatori si komplikacioni më i madh
- c. ulçera peptike
- d. thatësi e lehtë e buzëve
- e. zhvendosja/ekstubimi aksidental

194. Në insuficiencën renale kronike, pacienti ka:

- a. edemë dhe çrregullime elektrolitike
- b. uremii
- c. anemi
- d. hiperkalcemia e qëndrueshme pa shenja të tjera
- e. rritje e filtrimit glomerular

195. Tek pacienti me sondë urinare, duhet të shmanget:

- a. kthesat/kink-et e tubit
- b. shkëputjet e panevojshme të sistemit të mbyllur
- c. ngritja e qeses mbi nivelin e fshikëzës
- d. higjiena perineale
- e. fiksimi i mirë i kateterit

196. Tek pacienti me rrezik për aspirim, ndërhyrja kryesore është:

- a. ushqyerja shpejt në pozicion shtrirë
- b. ngritja e kokës së krevatit
- c. dhënia e lëngjeve pa mbikëqyrje
- d. vlerësimi i gëlltitjes para ushqyerjes
- e. mbajtja gati e aspiratorit dhe mbikëqyrja gjatë ushqyerjes

197. Tek pacienti me dëm në palcën kurrizore, rreziku kryesor është:

- a. glaukoma akute
- b. infeksioni i veshit të mesëm
- c. rritja e forcës spontane
- d. hiperaktiviteti motorik
- e. kompromisi respirator, veçanërisht në dëmtime të larta

198. Tek pacientët me sëmundje kronike, edukimi kryesor është:

- a. vetëmenaxhimin e sëmundjes
- b. ndalimin e çdo aktiviteti fizik pavarësisht këshillës
- c. aderencën në terapi
- d. mospërdorimin e kontrollit periodik
- e. njohjen e shenjave të përkeqësimit dhe ndryshimet e stilit të jetës

199. Tek pacienti me tamponadë kardiake, triada e Beck përfshin:

- a. hipotension
- b. krepitacione të bazave si element i Beck-ut
- c. distension i venave jugulare
- d. bradikardi sportive
- e. tinguj të zemrës të mbytur

200. Tek pacienti me ICV hemorragjike, infermieri duhet të shmangë:

- a. antikoagulantët/antiagregantët pa urdhër specifik
- b. dhënien e ushqimit/lëngjeve orale pa vlerësim të gëlltitjes
- c. mbajtjen e kokës 30°
- d. veprimet që rrisin presionin intrakranial
- e. monitorimin e shenjave vitale

201. Pas formulimit të diagnozës infermiere, cili është hapi i radhës në procesin infermior?

- a. vlerësimi fillestar
- b. implementimi i ndërhyrjeve
- c. planifikimi i kujdesit
- d. evaluimi i rezultateve
- e. dokumentimi administrativ rutinë

202. Çfarë përfshihet në diagnozën infermiere?

- a. emrin e saktë të bakterit
- b. dozën e antibiotikut
- c. shkallën e manifestimeve (shenjat/simptomat) kur është diagnozë reale
- d. reaksionet/problemet e pacientit ndaj gjendjes shëndetësore
- e. etiologjinë ose faktorët kontribues

203. Cila është diagnozë infermirore valide?

- a. rrezik për infeksion i lidhur me kateterin venoz
- b. pneumoni lobare akute
- c. apendicit akut
- d. frakturë e femurit të djathtë
- e. sepsis bakteriale

204. Cili formulim paraqet më mirë një objektiv afatgjatë infermieror?

- a. Pacienti do të raportojë dhimbje $\leq 3/10$ brenda 30 minutave.
- b. Pacienti do të kryejë frymëmarrje të thellë çdo orë gjatë turnit.
- c. Pacienti do të ecë 20 metra me ndihmë deri në fund të ditës.
- d. Pacienti do të demonstrojë vetëmenaxhim korrekt të insulinës brenda 4 javëve.
- e. Pacienti do të ketë diurezë >30 mL/orë gjatë 2 orëve të ardhshme.

205. Cilat nga veprimet më poshtë konsiderohen ndërhyrje infermirore të pavarura?

- a. edukimi i pacientit për ushtrime kollitjeje dhe frymëmarrjeje të thellë
- b. transfuzioni i eritrociteve sipas urdhrit
- c. ripozicionimi i pacientit çdo 2 orë
- d. titrimi i vazopresorit sipas protokollit
- e. vlerësimi i integritetit të lëkurës në çdo turn

206. Vlerësimi final bëhet për të përcaktuar:

- a. nëse qëllimet janë arritur
- b. nevojën për modifikim të ndërhyrjeve
- c. efektivitetin e planit të kujdesit
- d. temperaturën e autoklavës
- e. grupin e gjakut

207. Kur ndryshohet plani i kujdesit?

- a. vetëm kur e kërkon familja
- b. vetëm pas daljes nga spitali
- c. kur gjendja e pacientit ndryshon
- d. kur shfaqen probleme ose prioritete të reja
- e. kur qëllimet nuk arrihen

208. Në procesin infermieror, "implementimi" nënkupton:

- a. kontrollin e faturave
- b. vendosjen e diagnozës mjekësore
- c. zbatimin e ndërhyrjeve të planifikuara
- d. planifikimin e ardhshëm pa veprim
- e. realizimin e kujdesit infermieror

209. Shembull i një rezultati pritshmërie është:

- a. pacienti ka apendicit akut
- b. pacienti është 70 kg
- c. pacienti ka mëlçi të zmadhuar
- d. pacienti është mashkull
- e. pacienti do të raportojë dhimbje $\leq 3/10$ brenda 30 minutave pas analgjezikut

210. Cili është qëllimi i diagnozës infermiere “Rrezik për ulçerë presioni”?

- a. parandalimin e dëmtimit të indeve
- b. ruajtjen e integritetit të lëkurës
- c. rritjen e temperaturës trupore
- d. shtimin e orekstit
- e. uljen e presionit mbi prominencat kockore

211. Cila nga këto është e dhënë subjektive?

- a. TA 150/90 mmHg
- b. SpO2 89%
- c. temperatura 38.6°C
- d. “kam dhimbje gjoksi”
- e. plaga me eritemë 2 cm

212. Cila është e dhënë objektive?

- a. “ndjej marramendje”
- b. “kam etje”
- c. “më dhemb barku”
- d. temperatura 38.5°C
- e. “jam i frikësuar”

213. Shembull i dokumentimit cilësor është:

- a. “u pa”
- b. plaga e thatë, pa drenazh; pacienti raporton dhimbje 3/10; analgjezik i dhënë sipas urdhrorit
- c. “u bë diçka”
- d. “gjendje normale”
- e. “pacienti është mirë”

214. Cili formulim është më i saktë si diagnozë infermiere reale sipas strukturës PES?

- a. rrezik për rënie i dëshmuar nga ecja e paqëndrueshme
- b. dhimbje akute e lidhur me incizionin kirurgjikal, dëshmuar nga verbalizimi i dhimbjes 8/10
- c. pneumoni lobare e djathtë me temperaturë 38.7°C
- d. insuficiencë renale akute e shoqëruar me oliguri
- e. hipoksemi me PaO2 55 mmHg

215. Cila veprimtari është ndërhyrje e varur?

- a. ripozicionimi i pacientit
- b. edukimi për përdorimin e inhalatorit
- c. vlerësimi i dhimbjes
- d. kujdesi oral
- e. administrimi i medikamentit sipas urdhrorit të mjekut

216. Procesi infermior është:

- a. proces vetëm mjekësor
- b. i përqendruar te pacienti
- c. metodë e zgjidhjes së problemeve
- d. proces sistematik dhe i vazhdueshëm
- e. procedurë vetëm administrative

217. Cili dokument është pjesë e planit të kujdesit?

- a. lista e faturave
- b. radiografia e toraksit
- c. lista e diagnozave, qëllimeve dhe ndërhyrjeve infermierore
- d. deklarata e punësimit
- e. raporti i autoklavës

218. Kur dokumentohen ndërhyrjet infermierore?

- a. menjëherë pas kryerjes së tyre
- b. vetëm në dalje
- c. vetëm kur ka komplikime
- d. në fund të javës
- e. para se të kryhen

219. Cili është prioritet në diagnozën “Rrezik për aspirim”?

- a. mbrojtja e rrugëve të frymëmarrjes
- b. largimi i aspiratorit nga dhoma
- c. ushqyerja e shpejtë në pozicion shtrirë
- d. ngritja e kokës së krevatit
- e. vlerësimi i gëlltitjes para ushqyerjes

220. Cila është diagnozë infermierore e bazuar në stres?

- a. frakturë e mbyllur
- b. ankth
- c. hiperkalemi
- d. aritmi ventrikulare
- e. bronkopneumoni

221. Cila është shenja më e hershme e hipoksisë?

- a. shqetësim/restlessness
- b. konfuzion i hershëm
- c. ankth i papritur
- d. konstipacion
- e. ikter

222. Cila vlerë alarmon për ventilim joefektiv?

- a. temperaturë 37°C
- b. BMI 23 kg/m²
- c. hemoglobina 14 g/dL
- d. natriumi 140 mmol/L
- e. rritje e PaCO₂ mbi vlerat normale ose në rritje progresive

223. Cili intervenim është prioritet te pacientët në ventilator?

- a. monitorimi i sinkronisë me ventilatorin dhe sekrecioneve
- b. heqja e alarmit të ventilatorit
- c. ulja e oksigjenit pa vlerësim
- d. kujdesi oral dhe parandalimi i VAP
- e. ruajtja e kalueshmërisë së rrugëve të frymëmarrjes

224. Qëllimi i sedacionit minimal është:

- a. të ruajë komoditetin
- b. të lejojë vlerësim neurologjik sa më të mirë
- c. të mbajë pacientin plotësisht pa reagim për kohë të gjatë
- d. të favorizojë sinkroninë me ventilatorin dhe mobilizimin e hershëm
- e. të shmangë çdo kontakt me pacientin

225. Te pacienti me shok septik pritet:

- a. hipoglicemi si gjetje e vetme
- b. puls të fortë periferik me normotension të qëndrueshëm
- c. laktat të rritur dhe perfuzion të dobët
- d. takikardi dhe oliguri
- e. hipotension

226. Cili është qasja e saktë në hipotension akut?

- a. fillimi i lëngjeve IV dhe monitorimi i presionit sipas protokollit
- b. ulja e kokës 45° dhe ecja
- c. dhënia e antihipertensivëve pa vlerësim
- d. pozicionimi supin me ngritje të këmbëve nëse nuk kundërintikohet
- e. sigurimi i ABC

227. Në një pacient me anafilaksi, cili është bari i zgjedhes?

- a. metformin PO
- b. adrenalinë (epinefrinë) IM
- c. warfarinë PO
- d. furosemid IV
- e. digoksinë IV

228. Cili është tregues i perfuzionit adekuat?

- a. gjendje mendore e kthjellët
- b. pulse shumë të dobëta
- c. diurezë ≥ 0.5 mL/kg/orë
- d. laktat në rritje
- e. mbushje kapilare < 2 sekonda dhe lëkurë e ngrohtë

229. Cili parameter duhet monitoruar në infuzionet e vazopresorëve?

- a. vlerësimin e vendit të infuzionit për ekstravazim
- b. madhësinë e këpucëve
- c. diurezën dhe perfuzionin periferik
- d. vetëm ngjyrën e flokëve
- e. presionin arterial/MAP

230. Cila mënyrë është më efektive për parandalimin e ulcerave të presionit?

- a. qëndrim i pandryshuar për pushim
- b. inspektimi i lëkurës dhe menaxhimi i lagështisë
- c. masazh i fortë mbi prominencat
- d. përdorimi i sipërfaqeve mbështetëse
- e. ripozicionimi i rregullt dhe ulja e presionit

231. Te pacienti me ICP të rritur, shmanget:

- a. mbajtja e kokës 30°
- b. mjedisi i qetë
- c. fleksioni i qafës dhe i ijëve
- d. pozicioni i sheshtë pa ngritje të kokës kur nuk indikohet
- e. manovra Valsalva/kollitja e panevojshme

232. Cila gjetje shtesë e mbështet diagnozën e tamponadës kardiake?

- a. pulsus paradoxus
- b. krepitacione bibazale si gjetja dominuese
- c. rash petekial i përhapur
- d. hiperglicemi e izoluar
- e. hiperperistaltikë intestinale

233. Cili gaz arterial sugjeron acidozë metabolike?

- a. PaCO₂ normal ose i ulur si kompensim
- b. pH i ulët
- c. HCO₃⁻ i ulët
- d. HCO₃⁻ i lartë
- e. pH i lartë

234. Gjatë vlerësimit fillestar, pacienti juaj iu pohon se ka errësim të vetëdijes, marramendje dhe alivanoset (humb përkohësisht vetëdijen). Pasi ia matni presioni e gjakut vlerat e fituara janë: 75/45 mmHg. Në çfarë pozite duhet të vendoset pacienti?

- a. pozicion pron
- b. pozicion Fowler i lartë
- c. pozicion supin me këmbët e ngritura
- d. Trendelenburg ekstrem i zgjatur
- e. pozicion ulur në karrige

235. Te ventilimi mekanik, qëllimi i PEEP është:

- a. të parandalojë kolapsin alveolar në fund të ekspirimit
- b. të zëvendësojë sedacionin
- c. të përmirësojë oksigjenimin
- d. të ulë drejtpërdrejt glukozën
- e. të mbajë alveolat të hapura

236. Cili është rreziku tek pacientët në vazopresorë?

- a. aritmi/mbingarkesë kardiake sipas barit
- b. myopi e përkohshme
- c. kapsllëk i lehtë
- d. ekstravazim dhe nekrozë të indeve
- e. ishemi periferike

237. Cila vlerë e laktatit sugjeron perfuzion të dobët?

- a. 1.8 mmol/L
- b. 0.8 mmol/L
- c. 1.5 mmol/L
- d. 1.1 mmol/L
- e. laktat >2 mmol/L, veçanërisht në rritje

238. Vlerësimi “GCS 8” nënkupton:

- a. nevojë të mundshme për mbrojtje të rrugëve të frymëmarrjes
- b. gjendje plotësisht normale
- c. komë ose alterim të rëndë të vetëdijes
- d. dëmtim të rëndë neurologjik
- e. ankth të lehtë

239. Cili parametër duhet monitoruar në transfuzion?

- a. temperaturën
- b. vetëm BMI
- c. madhësinë e pupilave
- d. shfaqjen e dispnesë, urtikaries ose dhimbjes së mesit
- e. presionin arterial dhe pulsën

240. Në ventilim, “asenkroni” nënkupton:

- a. efekt anësor i insulinës
- b. aritmi sinusale beninje
- c. mospërputhje mes përpjekjes së pacientit dhe ciklit të ventilatorit
- d. ulje e temperaturës
- e. ndërprerje e perfuzionit renal

241. Cili është prioriteti infermieror të një pacient me status epilepticus gjatë krizës?

- a. mbajtja forcërisht e gjymtyrëve
- b. futja e sendeve në gojë
- c. përgatitja për oksigjen/benzodiazepinë sipas protokollit
- d. mbrojtja e rrugëve të frymëmarrjes dhe e pacientit nga dëmtimi
- e. matja e kohëzgjatjes së krizës

242. Cila është ngjyra standarde e kanulës 18G sipas kodit të ngjyrave?

- a. portokalli
- b. blu
- c. e kuqe
- d. e zezë
- e. jeshile

243. Gjatë monitorimit të pacientit me drenim ventrikular, prioritet është:

- a. ruajtja e sistemit steril të mbyllur
- b. zbrazja e shpeshtë pa dokumentim
- c. niveli korrekt i drenit sipas referencës anatomike (zakonisht tragusi)
- d. monitorimi i presionit intrakranial dhe sasisë së drenazhit
- e. ngritja e drenit mbi kokë pa referencë

244. Cili është veprimi i parë kur pacienti me paralizë faciale (Bell palsy) nuk mbyll syrin?

- a. ushtrime intensive të fytyrës menjëherë
- b. larja e syrit me alkool
- c. mbrojtja e syrit me pika lubrifikuese dhe/ose mbulim
- d. aplikimi i nxehtësisë së fortë direkt në korne
- e. mbajtja e syrit të hapur pa mbrojtje

245. Çfarë nënkupton “rigiditeti cogwheel”?

- a. dhimbje torakale
- b. rezistencë e ndërprerë si “rrotë me dhëmbëza” gjatë lëvizjes pasive
- c. mungesë totale e tonusit muskolor
- d. tremor vetëm në gjumë
- e. paralizë flakside e menjëhershme

246. Me cilën pajisje matet zakonisht saturimi i oksigjenit?

- a. spirometër
- b. pulso-oksimetër
- c. elektrokardiograf
- d. otoskop
- e. oftalmoskop

247. Në një pacient me GCS 7, çfarë pritet?

- a. përmirësim të plotë neurologjik
- b. dëmtim të rëndë të vetëdijes
- c. mungesë rreziku për aspirim
- d. nevojë të mundshme për intubim/mbrojtje të rrugëve të frymëmarrjes
- e. gjendje orientimi të plotë

248. Shenjë e goditjes cerebrale ishemike së hershme është:

- a. edemë e këmbëve
- b. dobësi e papritur e krahut ose këmbës
- c. vështirësi në të folur
- d. rënie e njëanshme e fytyrës
- e. dhimbje kronike barku

249. Cili është qëllimi kryesor i pozicionimit 30° në IKT të rritur?

- a. të rrisë presionin venoz jugular
- b. të përmirësojë kthimin venoz cerebral
- c. të nxisë aspirimin
- d. të ulë presionin intrakranial
- e. të përkeqësojë perfuzionin cerebral

250. Në rast të krizës së migrenës, infermieri duhet:

- a. ta vendosë pacientin në mjedis të qetë dhe me dritë të ulët
- b. të japë ushqime me aromë të fortë
- c. të administrojë analgjezik/antiemetik sipas urdhrit
- d. të vlerësojë shenjat neurologjike dhe intensitetin e dhimbjes
- e. ta nxisë në aktivitet fizik intensiv

251. Cili është kriteri më i rëndësishëm para dërgimit në sallë të pacientit për anestezi të përgjithshme?:

- a. vlerësimi i dokumentacionit dhe përgatitjes paraoperative
- b. vetëm ngjyra e flokëve
- c. verifikimi i identitetit dhe pëlqimit të informuar
- d. konfirmimi i agjërimit (NPO) sipas protokollit
- e. vetëm madhësia e këmbës

252. Të vjellat pas operacionit (PONV) trajtohen fillimisht me:

- a. insulinë subkutane
- b. antiemetik (p.sh., ondansetron) sipas urdhrit
- c. antibiotik oral
- d. laksativ stimulues
- e. heparinë IV

253. Shenja më e hershme e hemorragjisë postoperative është:

- a. hipotermia e lehtë
- b. rritja e diurezës
- c. takikardia
- d. mioza
- e. bradikardia

254. Në plagët kirurgjikale të kontaminuara, infermierët monitorojnë për:

- a. ethe dhe dhimbje në rritje
- b. ulje e pulsit femoral
- c. skuqje dhe ngrohtësi lokale
- d. rritje e oreksit
- e. sekrecion purulent/erë e keqe

255. Cili është vendi për matjen e pulsit tek foshnjat?

- a. arteria temporale
- b. arteria brakiale
- c. arteria karotide
- d. arteria tibiale posteriore
- e. arteria radiale si zgjedhja më e zakonshme të të gjitha foshnjat

256. Në vendosjen e drenit Jackson-Pratt, infermieri verifikon:

- a. që rezervuari të mos zbrazet kurrë
- b. që rezervuari të jetë i kompresuar dhe me suction
- c. patencën e drenit pa bllokime
- d. që dreni të mbahet i hapur në ajër
- e. sasinë dhe ngjyrën e drenazhit

257. Cilës komplikim i paraprin oliguria postoperative?

- a. hipotiroidizmit
- b. hipovolemisë
- c. insuficiencës renale akute
- d. shokut
- e. laringitit

258. Tek një pacient me stomë të freskët ileostome, kujdesi fillestar është:

- a. ushqimi me fibra të larta menjëherë pa vlerësim
- b. mbrojtja e lëkurës peristomale
- c. vendosja e presionit të fortë mbi stomë
- d. monitorimi i output-it të lëngshëm dhe bilancit të lëngjeve
- e. vlerësimi i ngjyrës së stomës

259. Cili është indikator i infeksionit të plagës kirurgjikale?

- a. eritemë/ngrohtësi lokale
- b. rritje e oreksit
- c. sekrecion purulent
- d. ethe ose dhimbje në rritje
- e. miozë e lehtë

260. Në drenazhin pleural (thoracostomy), prioritet është:

- a. ngritja e shishes mbi pacientin
- b. ruajtja e water-seal dhe patencës së tubit
- c. klemimi rutinë pa indikacion
- d. sistemi të mbahet nën nivelin e kraharorit
- e. vlerësimi respirator dhe për ajër/leak sipas sistemit

261. Cila është ndërhyrja e parë tek hipoglicemia akute?

- a. pozicion Trendelenburg i zgjatur
- b. matja e glukozës dhe dhënia e karbohidratit me veprim të shpejtë nëse pacienti është i vetëdijshëm
- c. dhënia e insulinës shtesë
- d. kufizimi i lëngjeve
- e. nëse është i pavetëdijshëm, përgatitja për dekstrozë IV/glukagon sipas protokollit

262. Cila gjendje mund të shkaktojë ulje të saturimit?

- a. osteoartriti
- b. pneumonia
- c. atelektaza/eksacerbimi i KOPB
- d. embolia pulmonare
- e. hipotiroidizmi

263. Tek pacientët me DKA, infermiera monitoron prioritarisht:

- a. madhësinë e pupilave
- b. kaliumin dhe elektrolitet
- c. balancën e lëngjeve dhe ketonet/acidobazën
- d. glukozën
- e. nivelin e bilirubinës

264. Një pacient me pneumoni duhet të inkurajohet të:

- a. të mobilizohet dhe të hidratohet sipas tolerancës
- b. të qëndrojë shtrirë gjithë ditën
- c. të përdorë spirometrin incentiv
- d. të kollitet dhe të marrë frymë thellë
- e. të shmangë çdo kollë

265. Simptomë tipike e astmës akute është:

- a. ekspir i zgjatur
- b. dispne
- c. bradikardi sportive
- d. wheezing
- e. hematemezë

266. Në hipertension urgjent, infermiera monitoron:

- a. dhimbjen e gjoksit/dispnenë dhe shenjat e organeve target
- b. presionin arterial
- c. vetëm gjatësinë trupore
- d. ngjyrën e syve
- e. shenjat neurologjike

267. Shenjë e hershme e insuficiencës renale akute prerrenale është:

- a. urinë e përqendruar
- b. hipertermi
- c. rritje e menjëhershme e diurezës
- d. hemoptizi
- e. oliguri

268. Pacientët me KOPB kanë zakonisht:

- a. bradikardi të thellë fiziologjike
- b. ekspir të zgjatur
- c. dispne kronike
- d. hiperinflacion/barrel chest dhe tolerancë të ulët ndaj aktivitetit
- e. hematemezë

269. Tek pacienti me emboli pulmonare, prioritet është:

- a. njoftimi urgjent dhe vendosja në pozicion gjysmë-ulur sipas tolerancës
- b. monitorimi i shenjave vitale dhe perfuzionit
- c. ushqyerja e menjëhershme orale
- d. sigurimi i oksigjenimit
- e. kufizimi i të gjitha lëngjeve pa arsye

270. Si llogaritet BMI?

- a. perimetri i belit / pesha
- b. pesha (kg) e pjesëtuar me gjatësinë (m) në katror
- c. glukozja / pesha
- d. pesha (kg) x gjatësia (m)
- e. mosha / gjatësia

271. Cila masë është thelbësore te pacientët me Clostridium difficile?

- a. izolim kontakti
- b. pajisje të dedikuara dhe pastrim sporocid
- c. larje e duarve me ujë dhe sapun
- d. maskë N95 në çdo rast
- e. vetëm dezinfektues me alkool si masë e vetme

272. Shenjë kryesore e sepsës është:

- a. hipotension ose alterim i perfuzionit
- b. miozë
- c. temperaturë jonormale
- d. takikardi/takipne
- e. rritje e oreksit

273. Në HIV me CD4 shumë të ulët, rrezik i madh është:

- a. infeksione oportuniste
- b. pneumoni nga Pneumocystis jirovecii dhe infeksione fungale/virale të rënda
- c. hipertension esencial
- d. otit seroz i vetëm
- e. frakturë e parakrahut

274. Koha e izolimit për gripin është zakonisht:

- a. deri sa të normalizohet BMI
- b. 30 ditë izolim ajror
- c. zakonisht rreth 5-7 ditë nga fillimi i simptomave dhe të paktën 24 orë pa ethe pa antipiretikë
- d. 24 orë fikse për të gjithë
- e. vetëm gjatë natës

275. Cila vlerë e BMI konsiderohet normale për të rriturit?

- a. 30-34.9 kg/m²
- b. ≥40 kg/m²
- c. 18.5-24.9 kg/m²
- d. 14-17 kg/m²
- e. 25-29.9 kg/m²

276. Shenjë alarmi te fëmijët me bronkiolit është:

- a. vështirësi në ushqyerje me shenja lodhjeje
- b. retraksione të theksuara/cianoze
- c. apne
- d. teshtitje e lehtë
- e. oreks normal

277. Tek dehidratimi i moderuar i fëmijëve, rekomandohet:

- a. ndalim total i lëngjeve
- b. antidiarrik i menjëhershëm pa vlerësim
- c. solucion rehidruës oral në sasi të vogla e të shpeshta
- d. vlerësim i shenjave të dehidratimit dhe urinimit
- e. ujë i thjeshtë në sasi të mëdha si zëvendësim i vetëm

278. Shenjë e hershme e shokut te fëmijët është:

- a. mbushje kapilare e zgjatur
- b. rritje e diurezës
- c. bradikardi e hershme
- d. takikardi
- e. ekstremitete të ftohta dhe zbehje

279. Cilën temperaturë konsiderojmë febrile te foshnjat nën 3 muaj?

- a. ≥38.0°C (rektale)
- b. ≥37.2°C orale
- c. ≥37.0°C aksilare
- d. ≥37.5°C në ballë si kriter universal
- e. ≥37.4°C timpanike

280. Te otiti media akut, fëmija zakonisht paraqet:

- a. ethe/irritabilitet
- b. ikter
- c. dispne e rëndë
- d. otalgji ose tërheqje e veshit
- e. ulje e dëgjimit ose shqetësim gjatë natës

281. Shenjë e preeklampsisë është:

- a. hipertension
- b. bradikardi fiziologjike
- c. dhimbje koke/çrregullime të shikimit ose edemë
- d. proteinuri
- e. hemoptizi

282. Në gjakderdhje postpartum, prioriteti është:

- a. vlerësimi i tonusit uterin dhe masazhi fundal
- b. fillimi i lëngjeve/uterotonikëve sipas urdhrorit
- c. kontrolli i gjakderdhjes dhe thirrja për ndihmë
- d. ushqyerja orale e menjëhershme
- e. ulja e monitorimit

283. Në abortin spontan, infermiera vlerëson:

- a. vetëm gjatësinë e flokëve
- b. vetëm temperaturën e ambientit
- c. sasinë e gjakderdhjes
- d. dhimbjen/krampet
- e. shfaqjen e indeve dhe stabilitetin hemodinamik

284. Shenjë e punës së rreme të lindjes:

- a. lehtësim me pushim ose hidratim
- b. mungesë e ndryshimit të qafës së mitrës
- c. dilatacion progresiv i qafës
- d. rritje e gjakderdhjes
- e. kontraksione të parregullta

285. Tek mastiti, ndihma e parë infermierore është:

- a. analgjezik dhe vlerësim për infektion/antibiotik sipas urdhrorit
- b. zbrazja e rregullt e gjirit/ushqyerja me gji sipas tolerancës
- c. kompresë e ngrohtë para ushqyerjes
- d. ndalimi i plotë i ushqyerjes me gji në çdo rast
- e. kompresë akulli mbi thithkë gjatë ushqyerjes

286. Cila qasje është e përshtatshme për pacientë me ankth akut?

- a. fjali të shkurtra e të thjeshta
- b. prani e qetë dhe mbështetëse
- c. udhëzim për frymëmarrje të kontrolluar dhe reduktim stimulimi
- d. prekja pa paralajmërim
- e. argumentim i ashpër

287. Për pacientët me çrregullim bipolar në fazën manike:

- a. të kufizohet stimulimi i tepërt
- b. të monitorohet ushqimi, hidratimi dhe gjumi
- c. të debatohet me idetë grandioze
- d. të inkurajohet aktiviteti i pakufizuar pa pushim
- e. të vendosen kufij të qartë

288. Gjatë intervistës me pacientinë konfuz, infermieri duhet:

- a. të japë shumë pyetje njëherësh
- b. të orientojë pacientin butësisht në kohë/vend
- c. të flasë ngadalë dhe qartë
- d. të përdorë fjali të gjata komplekse
- e. të bëjë pyetje të thjeshta, një nga një

289. Shenjë e hershme e deliriumit:

- a. luhatje e nivelit të vetëdijes
- b. kujtesë e dobët progresive shumëvjeçare si shenjë e vetme
- c. shqetësim/restlessness
- d. rritje e peshës
- e. çrregullim akut i vëmendjes

290. Tek të rinjtë me ankth, mbështetja infermierore përfshin:

- a. shmangie totale e komunikimit
- b. mësim i teknikave të përballimit/frymëmarrjes
- c. nxitje për përdorim të alkoolit "qetësues"
- d. inkurajim për rutinë, gjumë dhe reduktim të stimuluesve
- e. dëgjim aktiv dhe validim i ndjenjave

291. Shenjë e obstruksionit akut të rrugëve të sipërme:

- a. diare
- b. retraksione dhe punë e shtuar e frymëmarrjes
- c. stridor
- d. ikter
- e. pamundësi për të folur ose cianoze

292. Ndërhyrja e parë te epistaksi anterior:

- a. marrje e ujit me pipë
- b. kompresion i pjesës së butë të hundës
- c. fryrje e fortë e hundës
- d. përkulje përpara
- e. shtrirje në shpinë me kokë mbrapa

293. Te faringiti bakterial zakonisht paraqitet:

- a. diarre ujore si gjetje tipike
- b. ikter
- c. eksudat tonsilar dhe nyje cervikale të dhimbshme
- d. dhimbje fyti
- e. ethe

294. Kujdesi infermieror pas tonsilektomisë përfshin:

- a. dhënia e lëngjeve të ftohta dhe vlerësimi i dhimbjes sipas protokollit
- b. injorimi i gëlltitjeve të shpeshta
- c. pozicion anësor ose gjysmë-ulur sipas tolerancës
- d. ushqim i fortë i nxehtë menjëherë
- e. monitorimi për gjakderdhje

295. Shenjë e laringitit akut te fëmijët:

- a. stridor inspirator
- b. zë i ngjirur
- c. hipertension arterial
- d. kollë "lehëse"
- e. hematemezë

296. Shenjë e sindromit të kompartamentit:

- a. oreks i shtuar
- b. dhimbje në shtrirje pasive
- c. prurit nazal
- d. dhimbje joproportionale
- e. parestezi/tension i kompartimentit

297. Tek frakturat e hapura prioriteti është:

- a. ecje e menjëhershme
- b. kontroll i gjakderdhjes
- c. mbulim steril i plagës
- d. imobilizim i gjymtyrës
- e. reponim forcërisht i kockës

298. Në pacientin me allçi, infermiera vlerëson:

- a. dhimbjen, ënjtjen dhe pikat e presionit
- b. vetëm presionin intraokular
- c. qarkullimin distal
- d. vetëm ngjyrën e flokëve
- e. ndjeshmërinë dhe lëvizjen e gishtave

299. Trajtimi i parë i dislokimit të shpatullës është:

- a. përgatitja për reduktim nga mjeku
- b. reduktimi forcërisht nga infermieri
- c. masazh i fortë i shpatullës
- d. aplikimi i akullit dhe analgjezia sipas urdhrit
- e. imobilizimi i gjymtyrës

300. Shenjë e osteomielitit:

- a. hipotermi
- b. ethe
- c. dhimbje kockore lokale
- d. rrahje të ngadalta fiziologjike
- e. skuqje/ënjtje mbi zonën e prekur

301. Prioriteti te pacienti me anafilaksi:

- a. administrimi i adrenalines IM sipas protokollit
- b. monitorimi i oksigjenimit dhe thirrja për ndihmë urgjente
- c. shtrirja e sheshtë pa vlerësim
- d. sigurimi i rrugëve të frymëmarrjes
- e. ushqyerja orale

302. Në arrest kardiak, ritmi i shokueshëm është:

- a. asistolia
- b. fibrilacioni ventrikular
- c. takikardia ventrikulare pa puls
- d. PEA
- e. ritmi sinus normal

303. Tek pacienti me astmë akute, infermiera:

- a. jep laksativ
- b. e vendos në Trendelenburg
- c. vendos pacientin në pozicion që lehtëson frymëmarrjen dhe jep O2 sipas nevojës
- d. monitoron frymëmarrjen dhe SpO2
- e. administron bronkodilator me veprim të shpejtë sipas urdhrit

304. Tek hiperkalemia e rëndë, infermiera pret administrimin e:

- a. kalcium glukonat/klorid sipas urdhrit
- b. beta2-agonist nebulizuar ose bikarbonat sipas indikacionit
- c. warfarinë
- d. hekur IV
- e. insulinë me glukozë

305. Cili është një karakteristikë që vlerësohet gjatë matjes së pulsit?

- a. forca/volumi
- b. gjatësia e flokëve
- c. ngjyra e syrit
- d. ritmi
- e. frekuenca

306. Tek sepsa, prioriteti është:

- a. njoftimi urgjent dhe përgatitja për antibiotikë/kultura sipas protokollit
- b. ulja e monitorimit
- c. ushqyerja orale e menjëhershme
- d. sigurimi i ABC
- e. fillimi i lëngjeve dhe monitorimi hemodinamik

307. Cili është funksioni i drenit torakal (chest tube)?

- a. të largojë gjakun ose lëngun nga hapësira pleurale
- b. të rikthejë presionin negativ dhe zgjerimin e mushkërisë
- c. të masë glukozën
- d. të largojë ajrin
- e. të zëvendësojë oksigjenin

308. Në helmimin me CO, prioritet është:

- a. kufizimi i lëngjeve
- b. dhënia e sedativëve si hap i parë
- c. masazhi i këmbëve
- d. administrimi i oksigjenit 100%
- e. sigurimi i rrugëve të frymëmarrjes dhe largimi nga burimi

309. Cila është shenja kryesore e goditjes nga dekompresioni tek zhytësit?

- a. otalgji
- b. dhimbje e fortë në nyje dhe muskuj ("the bends")
- c. kollë produktive kronike
- d. hipoglicemi
- e. dispne e lehtë nga ankthi

310. Në pacientin e intubuar, infermiera monitoron:

- a. pozicionin e tubit dhe presionin e manshetës
- b. sekrecionet dhe patencën e rrugëve të frymëmarrjes
- c. SpO₂/ABG dhe parametrat respiratorë
- d. perimetrin abdominal
- e. gjatësinë e flokëve

311. Burimi primar i të dhënave gjatë vlerësimit infermieror është:

- a. literatura shkencore
- b. pacienti
- c. farmacia spitalore
- d. kartela e një pacienti tjetër
- e. lista e inventarit të repartit

312. Diagnosa infermierore formullohet për të:

- a. të vendosë diagnozën radiologjike
- b. të përshkruajë barnat
- c. të caktojë faturimin
- d. të udhëheqë planin e kujdesit infermieror
- e. të identifikojë problemet dhe reagimet e pacientit

313. Cili formulim është shkruar saktë si qëllim infermieror i orientuar drejt pacientit?

- a. Infermieri do të monitorojë saturimin çdo 2 orë.
- b. Pacienti do të mbajë saturim 94% ose më shumë në ajër ambiental brenda 12 orëve.
- c. Të administrohet oksigjen sipas urdhrit.
- d. Gjendja respiratore të vëzhgohet vazhdimisht.
- e. Pacienti të përmirësohet sa më shpejt.

314. Intervenimet infermierore janë:

- a. diagnoza mjekësore
- b. duhet të bazohen në vlerësim dhe evidencë
- c. veprime të planifikuara për arritjen e qëllimeve
- d. vendime financiare
- e. mund të jenë të pavarura, të varura ose bashkëpunuese

315. Gjatë fazës së evaluimit infermieror, infermieri duhet të:

- a. krahasojë rezultatet aktuale me qëllimet e planit
- b. vendosë nëse plani i kujdesit duhet modifikuar
- c. caktojë diagnozën mjekësore përfundimtare
- d. përshkruajë terapinë farmakologjike
- e. përgatisë raportin financiar të repartit

316. Etika infermierore kërkon:

- a. diskriminim sipas moshës
- b. respektim të dinjitetit dhe autonomisë
- c. ruajtje të konfidencialitetit
- d. veprim në të mirë të pacientit pa dëmtim
- e. fshehje të gabimeve

317. Dokumentimi i saktë infermieror është i rëndësishëm sepse:

- a. është dokument ligjor
- b. nuk ka vlerë në auditim
- c. siguron vazhdimësi të kujdesit
- d. lehtëson komunikimin e saktë ndërprofesional
- e. zëvendëson vlerësimin klinik

318. Prioriteti infermieror përcaktohet bazuar në:

- a. rastësisë
- b. sigurisë së pacientit
- c. preferencës personale të infermierit
- d. urgjencës klinike/ABC
- e. nevojave më kritike dhe rezultateve të vlerësimit

319. Delegimi kërkon:

- a. delegim pa vlerësim
- b. detyrën e duhur për delegim
- c. braktisje të plotë të përgjegjësisë
- d. personin e duhur për detyrën
- e. mbikëqyrje dhe komunikim të qartë

320. Qëllimi i edukimit shëndetësor është:

- a. të përmirësojë aderencën dhe vendimmarrjen e informuar
- b. të kufizojë autonominë
- c. të zëvendësojë terapinë mjekësore
- d. të rrisë vetëkujdesin
- e. të parandalojë komplikimet dhe sëmundjen

321. Cila është ndërhyrja infermierore kryesore pas kolecistektomisë laparoskopike?

- a. inkurajimi i frymëmarrjes së thellë dhe mobilizimit të hershëm
- b. vlerësimi i plagëve dhe nauzes pas operacionit
- c. ushqim i rëndë menjëherë pa tolerancë
- d. kufizimi i plotë i lëvizjes për javë të tëra
- e. monitorimi i dhimbjes dhe shenjave vitale

322. Tek pacienti pas laparotomisë, shenja më e hershme e ileusit paralitik është:

- a. ikter
- b. mungesë/ulje e zhurmave intestinale
- c. poliuri
- d. distension abdominal
- e. mungesë e kalimit të gazrave

323. Cili është prioriteti tek pacienti me dren Redon?

- a. matja e sasisë/ngjyrës së drenazhit
- b. ngritja e rezervuarit mbi plagë
- c. klemimi rutinë i drenit
- d. patenca e drenit dhe ruajtja e vakuimit
- e. vëzhgimi për gjakderdhje ose infeksion

324. Cili ndryshim e bën më të dyshuar hemorragjinë postoperatore aktive?

- a. drenazh seroz në sasi të vogël
- b. ekimozë e vjetër pa zgjerim
- c. rritje e shpejtë e drenazhit me gjak të kuq të ndezur
- d. kruarje rreth plagës
- e. sekrecion i trashë i verdhë

325. Cili pozicion rekomandohet pas operacionit tiroideor?

- a. pron
- b. Trendelenburg
- c. semi-Fowler
- d. shtrirje e sheshtë pa jastëk
- e. mbështetje e qafës dhe shmangie e fleksionit të tepruar

326. Në hernie inguinale e inkarceruar, prioriteti infermieror është:

- a. mbajtja NPO
- b. aplikimi i nxehtësisë lokale
- c. shtyrja e hernies me forcë
- d. përgatitja për ndërhyrje urgjente sipas urdhrit
- e. vlerësimi për shenja të obstruksionit/strangulimit

327. Cila nga këto është shenjë e infeksionit të plagës?

- a. sekrecion purulent
- b. miozë
- c. ngrohtësi dhe dhimbje
- d. skuqje lokale
- e. gojë e thatë

328. Në drenazhin biliar T-tube, infermieri duhet:

- a. ta mbajë qesen në nivelin e barkut
- b. të monitorojë sasinë dhe ngjyrën e bilës
- c. të shmangë kthesat dhe klemimin pa urdhër
- d. ta zbrazë pa dokumentim
- e. ta ngrëjë mbi abdomen

329. Cila vlerë sugjeron shok hemorragjik?

- a. SpO2 99% në ajër ambiental
- b. temperaturë 36.8°C
- c. TA 80/50 mmHg me takikardi dhe perfuzion të dobët
- d. TA 120/80 mmHg pa ankesa
- e. TA 130/85 mmHg me puls 72/min

330. Cila është ndërhyrje infermierore për të parandaluar trombozën postoperatore?

- a. qëndrim i pandryshuar në shtrat
- b. çorape kompresive/antikoagulum sipas urdhrit
- c. ushtrimet e këmbëve
- d. mobilizimi i hershëm
- e. dehidratim i qëllimshëm

331. Në ileus mekanik pritet:

- a. dhimbje kolikative abdominale
- b. zhurma intestinale të larta fillimisht dhe mungesë e gazrave
- c. ikter
- d. hipoglicemi si gjetje kryesore
- e. të vjella dhe distension

332. Pas stome kolostomie, prioritet është:

- a. vlerësimi i stomës dhe output-it
- b. kujdesi për lëkurën peristomale
- c. matja e ICP
- d. pozicion Trendelenburg
- e. edukimi fillestar i pacientit/familjes

333. Në plagën kirurgjike me sutura, e keqja më urgjente është:

- a. skuqje e lehtë e lëkurës
- b. nauze e përkohshme
- c. kruarje e lehtë
- d. dhimbje minimale në vend
- e. dehishenca/evisceracioni

334. Cili komplikim pritet pas amputimit të gjymtyrës?

- a. otit media
- b. hipotiroidizëm
- c. dhimbje fantomë
- d. gjakderdhje e plagës
- e. infeksion ose kontraktura nëse mungon rehabilitimi

335. Ngjitja e enëve (stripping) është procedurë për:

- a. hemorroidet e brendshme
- b. venat varikoze
- c. ulçerat gastrike
- d. bronkiektazitë
- e. aneurizmat cerebrale

336. Si quhet gjendja kur temperatura trupore është mbi 38°C?

- a. analgjezi
- b. ethe/pireksi
- c. bradikardi
- d. hipotermi
- e. eutermi

337. Pozicioni i rekomanduar për dren Pleurovac është:

- a. nën nivelin e kraharorit
- b. në dysHEME pranë kokës
- c. mbi nivelin e kokës
- d. mbi abdomen
- e. në të njëjtin nivel me zemrën gjithmonë

338. Për parandalimin e atelectazës postoperative përdoret:

- a. shtrirje e vazhdueshme e palëvizshme
- b. kufizim i frymëmarrjes nga dhimbja
- c. frymëmarrje e thellë dhe kollitje
- d. spirometri incentiv
- e. mobilizim i hershëm

339. Ndërhyrje për të reduktuar nauzen postoperative:

- a. antiemetik sipas urdhrit
- b. pozicionim gradual dhe shmangie e aromave të forta
- c. ushqim yndyror i rëndë menjëherë
- d. ofrim i lëngjeve të vogla sipas tolerancës
- e. shtrirje plotësisht e sheshtë pas të vjellave

340. Tek pacientët me stomë, lëkura irritohet më shpesh nga:

- a. mungesa e dritës
- b. kontakti me feçet/effluent-in
- c. hipoglicemia
- d. djersa e ballit
- e. pajisja e papërshtatshme dhe rrjedhja e qeses

341. Cila është shenja e hemorragjisë intracerebrale?

- a. dhimbje koke e papritur e fortë
- b. eritremë lokale në krah
- c. të vjella
- d. ulje e vetëdijes dhe deficit neurologjik
- e. kollë produktive kronike

342. Sa shpesh rekomandohet zakonisht kontrolli i vendit të kanulës venoze?

- a. rregullisht dhe të paktën çdo 4 orë, si dhe para/pas përdorimit të linjës ose më shpesh për barna irrituese
- b. vetëm kur pacienti ankohet
- c. nuk ka nevojë nëse rrjedh mirë
- d. vetëm një herë në ditë
- e. çdo 24 orë pa përjashtim

343. Cili është një veprim infermieror për uljen e temperaturës së lartë?

- a. të administrojë antipiretik sipas urdhrit
- b. ta mbulojë me batanije shtesë
- c. të heqë mbulesat e tepërta
- d. ta lërë pa vlerësim të shenjave vitale
- e. të sigurojë lëngje dhe masa fizike të buta

344. Shenjë e rritjes së ICP është:

- a. pupila të pabarabarta ose triada e Cushing-ut
- b. të vjella dhe cefale
- c. diarre
- d. ulje e GCS
- e. rritje e oreksit

345. Pozicion i rekomanduar në ICP të rritur:

- a. kokë e përkulur përpara
- b. Trendelenburg
- c. kokë e ngritur rreth 30°
- d. qafë në pozicion neutral
- e. supin plotësisht i sheshtë

346. Në paralizë faciale periferike, pritet:

- a. hemianopsi
- b. hemiparezë e kontralateralit si gjetje tipike
- c. mungesë e rrudhosjes së ballit në anën e prekur
- d. rënie e këndit të gojës në të njëjtën anë
- e. pamundësi për të mbyllur syrin në anën e prekur

347. Në meningjit, shenja Kernig është:

- a. zbehje e pulpit dentar
- b. puls paradoksal
- c. pozitivitet i testit Homans
- d. dhimbje/rezistencë gjatë shtrirjes së gjurit me ijën të fleksuar
- e. wheezing expirator

348. Si e dallon një hematuri?

- a. diare e përgjakshme
- b. urinë me ngjyrë të kuqe ose "ngjyrë çaji"
- c. sekrecion purulent nazal
- d. rritje e bilirubinës në serum
- e. prania e eritrociteve në analizën e urinës

349. Cila ndërhyrje është prioritet në stroke hemorragjike?

- a. administrimi i ushqimit oral menjëherë
- b. ulja e kokës në nivelin e trupit
- c. sigurimi i rrugëve të frymëmarrjes
- d. parandalimi i rritjes së ICP dhe përgatitja për ndërhyrje sipas protokollit
- e. monitorimi neurologjik dhe i TA

350. Në pacientin me paraplegji, komplikacion i shpeshtë është:

- a. infeksione urinare
- b. otit media
- c. hipertiroidizëm
- d. ulçera të presionit
- e. trombozë dhe kontraktura nga imobilizimi

351. Në epilepsi, faktori që rrit rrezikun e krizave është:

- a. mjedisi i qetë
- b. alkooli/ethe/stimulues të tjerë individualë
- c. privimi nga gjumi
- d. mosmarrja e barnave antiepileptike
- e. hidrimi i mirë

352. Në hemiplegji, pozicioni i krahut të prekur duhet të jetë:

- a. i fiksuar fort në fleksion
- b. jo i varur poshtë krevatit
- c. i lënë i lirë pa mbështetje
- d. në pozicion anatomik sa më korrekt
- e. i mbështetur mbi jastëk

353. Shenjë e stroke në hemisferën e majtë:

- a. hemianopsi bilaterale si shenjë e vetme
- b. bradikardi sportive
- c. dobësi e anës së djathtë
- d. ikter
- e. afazi

354. Tek Guillain-Barré, komplikacioni më i rrezikshëm:

- a. otiti media
- b. gastriti akut
- c. hipertensioni esencjal
- d. hiperglicemia e lehtë
- e. insuficienca respiratore

355. Simptomë e neuropatisë diabetike:

- a. ulje e ndjeshmërisë mbrojtëse
- b. djegie ose dhimbje neuropatike
- c. mpirje dhe ndjesi shpimi gjilpërash në këmbë
- d. stridor
- e. hematemezë

356. Në pacientët me traumë kurrizore C4, rreziku kryesor:

- a. otit media
- b. migrenë me aura
- c. gastrit akut
- d. insuficiencë respiratore
- e. hipotiroidizëm

357. Testi FAST përdoret për:

- a. matjen e presionit venoz qendror
- b. vlerësimin e frakturës së femurit
- c. detyrimin e kollës produktive
- d. njohjen e shpejtë të shenjave të stroke
- e. vlerësimin e hipoglicemisë

358. Hipotonia muskulare është tipike për:

- a. rigiditet parkinsonian
- b. lezion i neuronit motorik periferik/flacciditet
- c. tetani hipokalcemike
- d. distoni akute nga antipsikotikët
- e. spasticitet piramidial

359. Në SLA (ALS), shpesh dëmtohet:

- a. neuronet motorike
- b. veshi i mesëm
- c. retina si organi primar i prekur
- d. mukozat gastrike
- e. muskulatura respiratore në ecuri

360. Shenjë e migrenës me aura:

- a. fenomene vizuale si drita vezulluese/skotoma
- b. parestezi ose mpirje kalimtare
- c. dhimbje barku kolikative
- d. hematemezë
- e. ikter

361. Cili është prioriteti i parë infermieror tek një pacient me pankreatit akut?

- a. monitorimi hemodinamik dhe për komplikime
- b. ushqyerje e menjëhershme me yndyrna
- c. mbajtja NPO dhe lëngje IV sipas urdhrit
- d. mobilizim intensiv
- e. kontrolli i dhimbjes

362. Cila gjetje laboratorike është më karakteristike për nekroze muskulore?

- a. bilirubinë e ulët
- b. hiperkalemi
- c. CK (kreatin kinaza) shumë e rritur
- d. mioglobinuri
- e. kalcium i lartë si gjetje tipike

363. Cili është qëllimi kryesor i përdorimit të CPAP te pacientët me apnea obstruktive të gjumit?

- a. të trajtojë infeksionin urinar
- b. të ulë glukozën
- c. të mbajë rrugët e sipërme të frymëmarrjes të hapura gjatë gjumit
- d. të reduktojë episodet e apnesë
- e. të përmirësojë oksigjenimin dhe cilësinë e gjumit

364. Cili ekzaminim bedside ndihmon më shpejt në konfirmimin e tamponadës kardiake?

- a. ekokardiografia bedside
- b. radiografia e toraksit
- c. troponina serike
- d. spirometria
- e. gazrat arteriale

365. Cili është prioriteti infermieror në statusin asthmaticus?

- a. ushqyerja orale
- b. ulja e monitorimit
- c. administrimi i bronkodilatorëve/kortikosteroideve sipas protokollit
- d. përgatitja për intubim nëse përkeqësohet
- e. sigurimi i oksigjenimit

366. Cila është ndërhyrja kryesore tek një pacient me hipoglikemi të rëndë të pavetëdijshëm?

- a. heparinë SC
- b. glukagon nëse nuk ka akses IV
- c. ndalim total i monitorimit
- d. kalcium oral
- e. dekstrozë IV sipas protokollit

367. Cila komplikacion është më e zakonshme pas një frakture të femurit?

- a. embolizëm yndyror
- b. glaukoma akute
- c. gjakderdhje/shok
- d. laringit
- e. trombozë venoze e thellë nga imobilizimi

368. Cila shenjë paralajmëron se një shtatzënë po kalon në preeklampsi të rënduar?

- a. dhimbje koke e fortë
- b. çrregullime të shikimit
- c. miozë
- d. oreks i shtuar
- e. dhimbje epigastrike/hiperrefleksi me TA në rritje

369. Cila është ndërhyrja kritike kur identifikohet se pacienti ka rigiditet të qafës dhe fotofobi?

- a. largim i monitorimit
- b. përgatitje për trajtim/antibiotik sipas urdhrit dhe vlerësim ABC
- c. dhënie e ushqimit oral
- d. njoftim urgjent i mjekut dhe monitorim neurologjik
- e. izolim me pika dhe masat e mbrojtjes

370. Cila është një shenjë e hershme e shokut septik?

- a. takikardi
- b. rritje e oreksit
- c. temperaturë jonormale dhe perfuzion i dobët në zhvillim
- d. miozë
- e. ndryshim i gjendjes mendore ose ankth i ri

371. Sa kohë rekomandohet zakonisht të qëndrojë një kanulë venoze periferike, nëse nuk ka komplikacione?

- a. 30 ditë pa kontroll
- b. nuk hiqet kurrë derisa të bllokohet
- c. 12 orë fikse
- d. 6-8 orë
- e. zakonisht 72-96 orë nëse nuk ka komplikacione, sipas politikës lokale dhe indikacionit klinik

372. Cila është ndërhyrja e parë infermierore në embolinë pulmonare të dyshuar?

- a. vlerësimi i shpejtë dhe monitorimi i shenjave vitale
- b. ecje e detyruar
- c. sigurimi i oksigjenimit
- d. njoftimi urgjent dhe vendosja në pozicion gjysmë-ulur sipas tolerancës
- e. ushqyerja me porcione të mëdha

373. Cili është qëllimi i përdorimit të heparinës në infarkt miokardial?

- a. të ulë rrezikun e trombozës së re/embolizimit
- b. të parandalojë zgjerimin e trombit
- c. të ulë temperaturën
- d. të shkrijë menjëherë trombin ekzistues si trombolitik
- e. të qetësojë dhimbjen si analgjezik kryesor

374. Cila është ndërhyrja kritike kur drenazhi torakal ndalon papritmas?

- a. ta ngrejë shishen mbi kraharor
- b. të kontrollojë tubin për kthesa, klemime ose obstrukcion
- c. ta shkëpusë tubin nga sistemi
- d. të njoftojë urgjentisht nëse nuk rikthehet drenazhi/ka përkeqësim
- e. të vlerësojë menjëherë pacientin për dispne dhe shenja të tensionit

375. Cili është qëllimi kryesor i përdorimit të EWS (Early Warning Score)?

- a. standardizimin e vlerësimit të shenjave vitale
- b. eskalimin në kohë të kujdesit
- c. zbulimin e hershëm të përkeqësimit klinik
- d. zëvendësimin e diagnozës mjekësore
- e. matjen e BMI

376. Cili është rreziku më i madh pas një djegieje të shkallës së dytë në 25% të trupit?

- a. otit media
- b. hipotiroidizëm
- c. humbje e lëngjeve dhe shok hipovolemik
- d. glaukoma
- e. infeksion i plagës së djegies

377. Cila është pozita e rekomanduar për pacientin pas një pneumonie të rëndë me sekrecione të shumta?

- a. ndryshim pozicionesh dhe drenazh postural sipas tolerancës
- b. semi-Fowler/Fowler i lartë
- c. genupektoral
- d. Trendelenburg
- e. supin i sheshtë pa lëvizje

378. Cili është treguesi më i besueshëm i perfuzionit periferik?

- a. perimetri abdominal
- b. mbushja kapilare
- c. bilirubina
- d. pulse femorale të forta te të gjithë
- e. niveli i glukozës

379. Cili është rreziku kryesor te pacientët me kateter urinar afatgjatë?

- a. hipoglicemia
- b. ulçera peptike
- c. infeksioni urinar i lidhur me kateterin
- d. migrena
- e. otit media

380. Cila është ndërhyrja e duhur pas një krize epileptike?

- a. ta ushqejë menjëherë
- b. ta zgjojë me forcë
- c. ta monitorojë në fazën postiktale
- d. ta vendosë në anë për të mbrojtur rrugët e frymëmarrjes
- e. të mos vendosë asgjë në gojë dhe të mos e mbajë me forcë

381. Cila gjetje sugjeron hipokalemi?

- a. hiperrefleksi i theksuar
- b. valë T të mprehta
- c. valë U ose T të sheshta në EKG
- d. parestezi ose ileus
- e. dobësi/krampe muskulore

382. Cili është hapi kryesor në procesin infermieror pas vlerësimit?

- a. sterilizimi
- b. diagnostikimi infermieror
- c. implementimi
- d. delegimi
- e. evaluimi final

383. Cila ndërhyrje parandaluese rekomandohet te pacientët me imobilizim të zgjatur?

- a. kufizim i hidratimit pa arsye
- b. profilaksi për DVT dhe kujdes për lëkurën
- c. qëndrim i pandryshuar
- d. ripozicionimi i rregullt
- e. ushtrime ROM dhe mobilizim sipas mundësisë

384. Cila është shenja kryesore e dehidratimit të rëndë tek fëmijët?

- a. sy të fundosur dhe turgor i dobët
- b. hipersalivim
- c. letargji
- d. oliguri dhe mukozë shumë të thata
- e. oreks i shtuar

385. Cili është veprimi i parë kur një pacient humb vetëdijen në ambulancë?

- a. të thërrasë për ndihmë dhe të sigurojë ABC
- b. ta lërë ulur pa vlerësim
- c. të vlerësojë përgjigjen e pacientit
- d. ta ushqejë me ujë
- e. të vendosë pacientin në pozicion të sigurt sipas gjendjes

386. Cila shenjë sugjeron gastrit akut?

- a. parehati pas ushqimit
- b. stridor
- c. hemianopsi
- d. dhimbje/djegje epigastrike
- e. nauze ose të vjella

387. Cila është ndërhyrja e parë te pacienti me hipernatremi?

- a. kufizim absolut i ujit pa vlerësim
- b. ushqim i kripur i detyruar
- c. vlerësim neurologjik dhe i statusit të hidratimit
- d. dhënie e menjëhershme e KCl IV push
- e. fillim i korrigjimit gradual të lëngjeve sipas urdhrat

388. Cila gjetje sugjeron DVT?

- a. miozë
- b. ënjtje njëanësore e gjymtyrës
- c. skuqje përgjatë venës
- d. hipoglicemi
- e. dhimbje dhe ngrohtësi lokale

389. Në cilin situatë përdoret manovra Heimlich?

- a. kur pacienti ka astmë kronike
- b. kur ka frakturë vertebrale
- c. kur ka hemoptizi
- d. kur ka epistaksë
- e. kur personi i vetëdijshëm ka obstrukcion të plotë të rrugëve të frymëmarrjes nga trup i huaj

390. Cili është prioriteti për pacientin me COPD gjatë përkeqësimit akut?

- a. Trendelenburg
- b. oksigjen i kontrolluar dhe monitorim i SpO2
- c. bronkodilatatorë dhe vlerësim i përkeqësimit
- d. pozicionim që lehtëson frymëmarrjen
- e. ushqim oral i menjëhershëm

391. Cili është një tregues i hershëm i sepsës te të moshuarit?

- a. rritje e oreksit
- b. bradikardi sportive
- c. konfuzion akut
- d. takipne
- e. rënia e funksionit pa temperaturë të lartë të domosdoshme

392. Cila proteinë është më e rëndësishme për vlerësimin e statusit ushqyes?

- a. natriumi
- b. hemoglobina
- c. troponina
- d. prealbumina
- e. albumina gjithmonë si treguesi më i ndjeshëm

393. Cili është prioriteti pas administrimit të morfinës IV?

- a. perimetri i krahut
- b. vlerësimi i presionit arterial
- c. matja e mprehtësisë vizuale
- d. monitorimi i sedacionit dhe SpO₂
- e. monitorimi i frekuencës respiratore

394. Cila gjendje shoqërohet me rrezik të lartë për sindromën e kompartimentit?

- a. otit media
- b. allçi ose fashë shumë e ngushtë/cirkumferenciale
- c. gastriti
- d. dëmtimet crush
- e. fraktura e tibias

395. Cili është qëllimi i profilaksisë me heparinë gjatë hospitalizimit?

- a. ulja e temperaturës
- b. parandalimi i embolisë pulmonare
- c. ulja e trombozës gjatë imobilizimit
- d. parandalimi i DVT
- e. rritja e oreksit

396. Cila shenjë tregon insuficiencë renale akute?

- a. hemianopsi
- b. edemë ose mbingarkesë me lëngje
- c. rritje e kreatininës/ureas
- d. hipersalivim
- e. oliguri

397. Cila është ndërhyrja e duhur te hipertermia malinje?

- a. mbulim me batanije të trasha
- b. administrimi i dantrolenit sipas protokollit
- c. ndërprerja e shkaktarit dhe thirrja urgjente për ndihmë
- d. ushqyerje orale
- e. ftohja aktive dhe korigjimi i acidozës/hiperkalemisë sipas urdhrit

398. Cili është rreziku kryesor pas një PICC line?

- a. infeksion i linjës
- b. trombozë/okluzion
- b. Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, marrin vendime në përputhje me ligjin material.
- c. Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, marrin vendime në përputhje me ligjin procedural.
- d. Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, veprojnë në përputhje me ligjin.

53. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:

- a. Procedimi administrativ përfundon brenda kohës së nevojshme për shqyrtimin e plotë të çështjes dhe zgjedhjen e saj nga organi i administratës publike.
- b. Procedimi administrativ përfundon gjithmonë brenda një periudhe kohore prej 3 muajsh nga dita e paraqitjes së kërkesës.
- c. Procedimi administrativ përfundon gjithmonë brenda një periudhe kohore prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.
- d. Procedimi administrativ përfundon sa më shpejtë të jetë e mundur por sidoqoftë brenda periudhës kohore të parashikuar nga ligji, me përjashtim të rastit kur shtyrja bëhet e detyrueshme për shkak të situatave të jashtëzakonshme. Në rast se ligji i posaçëm nuk parashikon një periudhë kohore (afat) për përfundimin e procedimit, ai duhet të përfundojë brenda 3 muajve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

54. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:

- a. Organi administrativ, të cilit i drejtohet ankimi administrativ shqyrton ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit të kontestuar.
- b. Organi administrativ, të cilit i drejtohet ankimi shqyrton vetëm ligjshmërinë e aktit të kontestuar.
- c. Organi administrativ të cilit i drejtohet ankimi shqyrton vetëm rregullsinë e aktit të kontestuar.

55. Ministria e Punëve Publike të Kosovës ka miratuar një leje ndërtimi për një banesë private në territorin e Komunës së Prishtinës. Leje e ndërtimit në këtë rast është një:

- a. Akti administrativ i vlefshëm nëse është në përputhje me kushtet dhe standartet urbanistike.
- b. Akti administrativ relativisht i pavlefshëm nëse është në kundërshtim me kushtet dhe standartet urbanistike.
- c. Akt i së drejtes civile.
- d. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm.

56. Komuna Pejë ka miratuar një leje ndërtimi për një banesë private në territorin e Komunës së Prishtinës. Leja e ndërtimit në këtë rast është një akt administrativ:

- a. I vlefshëm nëse është në përputhje me kushtet dhe standartet urbanistike.
- b. Relativisht i pavlefshëm nëse është në kundërshtim me kushtet dhe standartet urbanistike.
- c. Akti administrativ i absolutisht i pavlefshëm.

57. Auditori i përgjithshëm i Kosovës, gjatë një kontrolli në departamentin e tatim taksave ka konstatuar se vlerësimi tatimor i bërë një subjekti tregtar privat është më i ulët seç duhej të ishte për shkak të një gabimi material në llogaritje nga inspektori tatimor. Bazuar në këtë konstatim, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës i ka njoftuar subjektin tregtar një akt administrativ në të cilin i kërkon shlyejën e detyrimit tatimor në masën e duhur. Në këtë rast akti administrativ i Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës është një akt administrativ:

- a. I vlefshëm nëse konstatimi i bërë nga Auditori i Përgjithshëm është i saktë.
- b. Relativisht i pavlefshëm nëse konstatimi i bërë nga Auditori i Përgjithshëm është i saktë.
- c. Relativisht i pavlefshëm nëse kjo ka ndodhur pas shume kohësh dhe detyrimi tatimor është parashkruar.
- d. Absolutisht i pavlefshëm.

58. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:

- a. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk prodhon asnjë pasojë juridike dhe mund të injorohet nga pala që detyrohet.
- b. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm prodhon pasojat juridike si një akt i vlefshëm deri në momentin kur shpallet si i pavlefshëm.
- c. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm prodhon pasojat juridike si një akt i vlefshëm deri në momentin që pala e interesuar kërkon shpalljen e tij si të pavlefshëm.

59. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i vërtetë:

- a. Ankimi administrativ ndaj një akti absolutisht të pavlefshëm mund të bëhet në çdo kohë.
- b. Ankimi administrativ ndaj një akti absolutisht të pavlefshëm mund të bëhet 30 ditë nga njoftimi i tij.
- c. Ankimi administrativ ndaj një akti absolutisht të pavlefshëm mund të bëhet 30 ditë nga publikimi i tij.
- d. Ankimi ndaj një akti absolutisht të pavlefshëm mund të bëhet 30 ditë nga hyrja e tij në fuqi.

60. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i vërtetë:

- a. Akti absolutisht i pavlefshëm mund të shpallet i tillë me kërkesë të palës së interesuar.
- b. Akti absolutisht i pavlefshëm mund të shpallet i tillë me kërkesë të palës apo me iniciativën e organit epror të organit që e ka nxjerrë atë.
- c. Akti absolutisht i pavlefshëm mund të shpallet i tillë me kërkesë të palës apo me iniciativën e organit epror të organit që e ka nxjerrë atë.
- d. Akti absolutisht i pavlefshëm mund të shpallet i tillë me kërkesë të çdo personi.

61. Mjetet e ankimit në rrugë administrative, ndaj një akti administrativ (përfshirë refuzimin apo heshtjen administrative) janë:

- a. Vetëm kërkesa për rishqyrtim.
- b. Vetëm ankesa administrative.
- c. Vetëm kërkesa për rishqyrtim dhe ankesa administrative.
- d. Kërkesa për rishqyrtim, ankesa administrative dhe padia.

62. Kërkesa për rishqyrtim si një nga mjetet e ankimit në rrugë administrative i drejtohet dhe është në kompetencë të:

- a. Drejtuar organit përgjegjës për aktin (që ka nxjerrë aktin apo ka refuzuar nxjerrjen e tij);
- b. Nëpunësit epror të nëpunësit përgjegjës për aktin.
- c. Organit epror të organit ku ushtron detyrën nëpunësi përgjegjës për aktin.
- d. Gjykatës kompetente për konfliktet administrative.

63. Ankesa administrative si një nga mjetet e ankimit në rrugë administrative i drejtohet dhe është në kompetencë të:

- a. Drejtuar nëpunësit përgjegjës për aktin (që ka nxjerr aktin apo ka refuzuar nxjerrjen e tij);
- b. Nëpunësit epror të nëpunësit përgjegjës për aktin.
- c. Organit më të lartë të atij përgjegjës për aktin.
- d. Gjykatës kompetente për konfliktet administrative

64. Ankimi administrativ i bërë në formën e ankesës duhet të dorëzohet:

- a. Tek organi që ka nxjerrë apo refuzuar nxjerrjen e aktit administrativ,
- b. Tek organi më i lartë i organit që ka nxjerrë apo refuzuar nxjerrjen e aktit të ankimuar.
- c. Në zgjedhjen e ankuesit të pikës a apo b.

65. Ankimi administrativ i bërë në formën e kërkesës për rishqyrim dorëzohet:

- a. Tek organi që ka nxjerrë apo refuzuar nxjerrjen e aktit administrativ.
- b. Tek organi më i lartë i organit që ka nxjerrë apo refuzuar nxjerrjen e aktit të ankimuar.
- c. Në zgjedhjen e ankuesit të pikës a apo b.

66. Afati për ankimin administrativ është:

- a. 30 ditë në çdo rast.
- b. 60 ditë në çdo rast.
- c. 30 ditë në rast të ankimit ndaj një akti administrativ apo refuzimit për të nxjerrë aktin dhe 60 ditë nga dorëzimi i kërkesës për nxjerrjen e aktit në rastin e heshtjes së plotë administrative.

67. Afati për ankimin administrativ ndaj një akti administrativ apo refuzimit për të nxjerrë aktin fillon të rrjedhë nga dita kur:

- a. Akti apo refuzimi është miratuar nga organi i administratës publike.
- b. Pala njihen me përmbajtjen e aktit administrativ.
- c. Ankuesi ka marrë dijeni për aktin apo refuzimin për nxjerrjen e tij apo ai është shpallur sipas legjislacionit të posaçëm.
- d. c ose d, së bashku.

68. Afati për ankimin administrativ ndaj mosveprimit (heshtjes së plote administrative) fillon të llogaritet nga dita kur:

- a. Akti apo refuzimi është miratuar nga organi i administratës publike.
- b. Nga dorëzimi i kërkesës për nxjerrjen e aktit.
- c. Ankuesi ka marrë dijeni për heshtjen.
- d. c ose a, se bashku.

69. Pala që cenohet nga një akt administrativ në të drejtat apo interesat e saj të ligjshme mund të ankohet si më poshtë:

- a. Të zgjedhë ti drejtohet organit administrativ që ka nxjerrë aktin apo organit epror të organit të administratës që ka nxjerrë aktin.
- b. Të zgjedhë ti drejtohet vetë organit të administratës që ka nxjerrë aktin, organit epror të organit të administratës që ka nxjerrë aktin apo drejtpërdrejtë gjykatës.
- c. Ti drejtohet drejtpërdrejtë gjykatës kompetente për konstestimin administrativ.

70. Cilat janë format e veprimtarisë administrative sipas ligjit të procedurave administrative të Kosovës:

- a. Vetëm akti administrativ (individual apo kolektiv).
- b. Akti administrativ dhe kontratat administrative.
- c. Akti administrativ dhe aktet reale.
- d. Akti administrativ, akti real dhe kontratat administrative.

71. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:

- a. Nje akt administrativ i pavlefshëm, shfuqizohet nga organi epror i organit që e ka nxjerrë atë akt.
- b. Nje akt administrativ i pavlefshëm, shfuqizohet nga vetë organi që e ka nxjerrë atë akt.
- c. Nje akt administrativ i pavlefshëm, revokohet nga vetë organi që e ka nxjerrë atë akt.

72. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i vërtetë:

- a. Një akt administrativ i pavlefshëm, revokohet nga organi epror i organit që e ka nxjerrë atë akt.
- b. Një akt administrativ i pavlefshëm, shfuqizohet nga vetë organi që e ka nxjerrë atë akt.
- c. Një akt administrativ i pavlefshëm, shfuqizohet nga organi epror i organit që e ka nxjerrë atë akt.

73. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:

- a. Dokumentet zyrtare (publike) që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, vetëm në rastet e parashikuar shprehimisht nga ligji.
- b. Dokumentet zyrtare (publike) që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, vetëm në rastet e parashikuar shprehimisht nga ligji dhe nëse kanë të bëjnë me një procedim administrativ mund të inspektohen nga pala e interesuar në këtë procedim.
- c. Dokumentet zyrtare (publike) që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.

74. Cila nga aktet e mëposhtëme është akt administrativ:

- a. Akte administrative me karakter rregullativ;
- b. Çdo vendim të organit të administratës publike, i cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjrisht, liritë ose interesat e personave.
- c. Akte që nxirren nga organet e administratës publike në kuadrin e transaksioneve private, në të cilat administrata publike është palë.

75. Gjykata kompetente për zgjedhjen e konflikteve administrative, si rregull, shqyrton:

- a. Ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative.
- b. Ligjshmërinë dhe rregullsinë e akteve përfundimtare administrative
- c. Rregullësinë e akteve përfundimtare administrative.

76. Për cilin nga tipet e mëposhtëme të akteve, NUK mund zhvillohet konflikti administrativ:

- a. Kundër heshtjes së organit administrativ epror që zgjidh ankimin ndaj një akti administrativ.
- b. Kundër akteve administrative, që përbëjnë një detyrim të përgjithshëm, të nxjerra nga organet e administratës, përveç kur ato çenojnë të drejtat e ligjshme të palëve.
- c. Kunder vendimit të dhënë nga organi epror në zgjidhjen e ankesës të bërë nga një qytetar ndaj një akti administrativ të paligjshëm.

77. Qëllimi i kontrollit gjyqësor mbi aktet administrative është:

- a. Sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera, të cilat të drejta dhe interesa janë çenuar me vendime individuale ose me veprimet e organeve të administratës publike,
- b. Sigurimi i ligjshmërisë të veprimtarisë së organeve të administratës publike.
- c. Fillimi i ndjekjes penale për nëpunësin përgjegjës për aktin e paligjshëm.
- d. Pohimet "a" dhe "b", më sipër, së bashku.

78. Cilat nga kategoritë e mëposhtëme NUK kanë të drejtën të nisin një konflikt administrativ në gjykatën kompetente:

- a. Personi fizik si dhe personi juridik, të cilit akti administrativ përfundimtar i ka shkelur ndonjë të drejtë apo interes ligjor.
- b. Një organ tjetër i administratës publike i cili vepron në mbrojtje të interesave publike
- c. Organi i administratës publike që ka nxjerre aktin nëse vlerëson se akti i tij ka qënë i pa rregullt.
- d. Avokati i Popullit, i cili vepron në mbrojtje të interesave publike.
- e. Shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike.

79. Paraqitja e padisë në konfliktin administrativ:

- a. Si rregull, nuk pezullon ekzekutimin e aktit administrativ.
- b. Pezullon ekzekutimin e aktit administrativ.
- c. E bën aktin administrativ të paefektshëm.
- d. Pezullon ekzekutimin e aktit për periudhën deri në dhënien e vendimit të shkallës së parë.

80. Në cilin nga rastet e mëposhtëme gjykata kompetente për konfliktet administrative NUK mund të hedhë poshtë, me vendim, padinë kundër një akti administrativ:

- a. Padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohëshme.
- b. Akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ.
- c. Është e qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj.
- d. Akti që kontestohet është vetëm pjesërisht i ligjshëm.
- e. Ekziston vendimi i formës së prerë, i nxjerrë në konfliktin administrativ, për të njëjtën çështje.

Kreu 3: Pyetje mbi njohuritë mbi shërbimin civil të Kosovës

81. Marrëdhënia e punësimit në shërbimin civil është marrëdhënie juridike:

- a. E të drejtës së punës.
- b. E të drejtës administrative.
- c. E të drejtës civile.

82. Cili nga pohimet e mëposhtëm përbën karakteristikën thelbësore të shërbimit civil:

- a. Ushtrimi i autoritetit publik.
- b. Punësimi në një institucion të administratës publike.
- c. Kryerja e një detyre të rëndësishme shtetërore.
- d. Marrëdhënia e besnikërisë me pushtetin politik.

83. Cila nga veprimtaritë e mëposhtëme NUK është veprimtari tipike që kryhet nga nëpunës civil:

- a. Marrja pjesë në formulimin e politikave.
- b. Monitorimi i zbatimit të rregullave.
- c. Hartimi dhe përgatitja e strategjive.
- d. Pastrimi i ambienteve të institucionit.
- e. Ndjekja e zbatimit të kërkesave ligjore nga qytetarët dhe bizneset.

84. Cila nga veprimtaritë e mëposhtëme NUK është veprimtari tipike që kryhet nga nëpunës civil:

- a. Marrja pjesë në formulimin e politikave.
- b. Monitorimi i zbatimit të rregullave.
- c. Hartimi dhe përgatitja e strategjive.
- d. Vozitja e një automjeti të një ministrie në shërbim të drejtorisë të financave.
- e. Ndjekja e zbatimit të kërkesave ligjore nga qytetarët dhe biznesi.

85. Cili nga pohimet e mëposhtëm NUK duhet të përbëjë ‘cilësi’ thelbësore të nëpunësit civil:

- a. Profesionalizmi.
- b. Integriteti
- c. Paanësia politike
- d. Përgjegjshmëria
- e. Besnikëria politike

86. Cili nga pohimet e mëposhtëm NUK është i saktë:

- a. Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për hartimin e politikave të menaxhimit të shërbimit civil.
- b. Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për mbikqyrjen e zbatimit të politikave të shërbimit civil.
- c. Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për propozimin e politikave në fushën e pagave dhe shpërblimeve.
- d. Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të nëpunësve civil ndaj vendimeve lidhur me marrëdhëniet e punësimit në shërbimin civil.

87. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është:

- a. Një institucion i pavarur që i raporton Kuvendit të Kosovës.
- b. Një institucion në varësi të Qeverisë së RKS-se.
- c. Pjesë e sistemit gjyqësor të RKS-se.

88. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është institucion përgjegjës për:

- a. Hartimi e politikave të shërbimit civil në RKS.
- b. Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së menaxhimit në shërbimin civil.
- c. Menaxhimin e shërbimit civil në RKS.
- d. Rekrutimin e nëpunësve të shërbimit civil.

89. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ka kompetencë në:

- a. Zgjedhjen e ankesave të nëpunësve civile ndaj akteve të menaxhimit lidhur me marrëdhënien e punësimit në shërbimin civil.
- b. Nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të nëpunësit civil.
- c. Hartimin e politikave shtetërore të shërbimit civil.

90. Cila nga kategoritë e mëposhtëme të personelit është pjesë e shërbimit civil të Kosovës:

- a. Stafi mësimor i sistemit arsimor.
- b. Stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe performuesit të artit,
- c. Personeli civil i punësuar në policinë e Kosovës.
- d. Zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës.
- e. Nëpunësit e administratës të Kuvendit të Kosovës.
- f. Zyrtarët doganorë të Doganave të Kosovës.

91. Cila nga kategoritë e mëposhtëme të personelit janë pjesë e shërbimit civil të Kosovës:

- a. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës.
- b. Stafi mësimor i sistemit arsimor.
- c. Stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe performuesit të artit.
- d. Zyrtarët doganorë të Doganave të Kosovës

92. Cila nga kategoritë e mëposhtëme të personelit NUK është pjesë e shërbimit civil të Kosovës:

- a. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës.
- b. Kryetarët e komunave.
- c. Personeli civil i punësuar në Doganat e Kosovës.
- d. Personeli civil i punësuar në policinë e Kosovës.

93. Cili nga pozitat e mëposhtme në një ministri NUK është pozite e shërbimit civil:

- a. Drejtori i nje Departamenti.
- b. Shef i nje divizion.
- c. Këshilltar i ministrit.
- d. Sekretari i Përgjithshëm.

94. Cila nga pozitat e mëposhtëme në një ministri NUK është pozitë e shërbimit civil:

- a. Drejtori i nje Departamenti.
- b. Shef i nje divizion.
- c. Sekretari i Përgjithshëm.
- d. Punonjësi i pastrimit.

95. Procedura e pranimit në shërbimin civil, përveçse në pozicionet e larta drejtuese organizohet nga:

- a. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil,
- b. Vetë institucioni qe ka vendin e lirë ku do të punësohet nëpunësi.
- c. Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil në Ministrinë e Administratës Publike.
- d. Ministria e Administratës Publike.

96. Cili nga parimet e mëposhtëm NUK është parim i përzgjedhjes për pranimin në shërbimin civil:

- a. Parimi i meritës.
- b. Parimi i transparencës.
- c. Parimi i besnikërisë politike.
- d. Parimi i profesionalizmit.
- e. Parimi i paanësise dhe mosdiskriminimit.

97. Cila nga kërkesat e mëposhtme NUK është kërkesë e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.

- a. Shtetësia e Republikës së Kosovës.
- b. Mosha madhore.
- c. Zotërimi i gjuhës angleze.
- d. Zotësia e plotë për të vepruar.

98. Cila nga kërkesat e mëposhtme NUK është kërkesë e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.

- a. Shtetësia e Republikës së Kosovës.
- b. Mosha mbi 30 vjeç.
- c. Zotësia e plotë për të vepruar.
- d. Posedim të të drejtave civile dhe politike.

99. Cila nga kërkesat e mëposhtme NUK është kërkesë e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.

- a. Shtetësia e Republikës së Kosovës.
- b. Zotësia e plotë për të vepruar.
- c. Vendbanimi në Kosovë.
- d. Posedim të të drejtave civile dhe politike.

100. Për secilën gradë të punës në shërbimin civil ka hapa në mënyrë progresive. Avancimi i nëpunësit civil nga hapi aktual në një hap më të lartë bëhet në bazë të :

- a. Vjetërsisë në punë.
- b. Rezultateve në punë.
- c. Vjetërsisë në punë dhe rezultateve në punë

101. Çdo kategori funksionale e nëpunësve civilë përfshin gradat e punës. Këto grada përcaktohen në bazë të:

- a. Përgjegjësisë dhe kompleksitetit të punës në pozitën përkatëse.
- b. Aftësive profesionale të nëpunësit që ushtron detyrën në pozitën përkatëse.
- c. Kualifikimeve dhe përvojës të nëpunësit që ushtron detyrën në pozitën përkatëse.

102. Cila nga pohimet e mëposhtëme NUK është i saktë:

- a. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte për përcaktimin e nevojave për trajnim individual ose të grupeve të nëpunësve civilë.
- b. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte për përcaktimin e përshtatshmërisë së nëpunësit civil për avancim në karrierë.
- c. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte për përcaktimin e ekzistimit të kushteve për shndërrimin e punës provuese në emërim ose në shkarkim;
- d. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte në përgjegjësinë disiplinore të nëpunësit.

103. Cili nga pohimet e mëposhtëm NUK është i saktë:

- a. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte në vazhdimin ose ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil.
- b. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte për përcaktimin e nevojave për trajnim individual ose të grupeve të nëpunësve civilë.
- c. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte për pranimin në shërbimin civil.

104. NUK përbën shkak për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil:

- a. Dorëheqja.
- b. Arritja e moshës së pensionit.
- c. Marrja e detyrës së funksionarit publik (politik).
- d. Paaftësinë e përhershme për ushtrimin e detyrës zyrtare për arsye shëndetësore;
- e. Dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë për mbajtjen e burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër.

105. NUK përbën shkak për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil:

- a. Paaftësia e përhershme për ushtrimin e detyrës zyrtare për arsye shëndetësore;
- b. Dënimi nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë për mbajtjen e burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër.
- c. Arritja e moshës së pensionit.
- d. Kryerja e detyrimeve ushtarake.

106. Autoritet kompetent për inicimin e procedurave për shkarkimin e sekretarëve të përgjithshëm në një ministri është:

- a. Ministri që drejton ministrinë përkatëse.
- b. Kryeministri i Kosovës.
- c. Ministria e Administratës Publike.
- d. Këshilli Mbikëqyrës i Shërbimit Civil.

107. Autoritet kompetent për marrjen e vendimit për shkarkimin e sekretarëve të përgjithshëm në një ministri është:

- a. Ministri që drejton ministrinë përkatëse.
- b. Kryeministri i Kosovës.
- c. Ministria e Administratës Publike.
- d. Komisioni i posaçëm disiplinor i ngritur për këtë qëllim me vendim të Qeverisë.

108. Autoritet kompetent për marrjen e vendimit për shkarkimin e një nëpunësi të nivelit drejtues në një komunë është:

- a. Kryetari i Komunës.
- b. Këshilli i Komunës.
- c. Komisioni i posaçëm disiplinor i ngritur për këtë qëllim në komunën përkatëse.
- d. Ministria e Administratës Publike.

109. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK është i sakte:

- a. Nëpunësi civil nuk do të zbatojë urdhërat që kërkojnë kryejën e një vepre në kundërshtim me ligjin.
- b. Nëpunësi civil nuk do të zbatojë urdhërat që kërkojnë moskryerjen e një vepre në kundërshtim me ligjin.
- c. Nëpunësi civil nuk do të zbatojë urdhërat që janë jashtë kompetencave të urdhëruesit.
- d. Nëpunësi civil nuk do të zbatojë urdhërat që jepen me gojë nga eprori i tij.

110. Në rast dyshimi se një urdhër i marrë kërkon kryerjen e një vepre në kundërshtim me ligjin, nëpunësi civil duhet të:

- a. Zbatojë urdhërin, pa e vënë në diskutim atë.
- b. Vetëm të refuzojë të zbatojnë urdhërin dhe të vazhdojë punën normalisht.
- c. Të refuzojë zbatimin e urdhërit dhe të kërkojë urdhër me shkrim nga eprori i tyre i drejtpërdrejtë.

111. Organi kompetent për marrjen e masave për shkelje të rënda administrative në shërbimin civil, për nëpunësit me përjashtim të nëpunësve të nivelit drejtues është:

- a. Eprori direkt i nëpunësit që ka kryer shkeljen disiplinore.
- b. Titullari i institucionit ku ushtron detyrën nëpunësi që ka kryer shkeljen disiplinore.
- c. Komisioni disiplinor i institucionit.
- d. Këshilli i Mbikëqyrjes së shërbimit civil.

112. Cili nga rastet e mëposhtëme NUK përbën shkak për pezullimin parandalues të një nëpunësi civil nga detyra:

- a. Kundër nëpunësit ka filluar ndjekja penale për kryerjen e një vepre penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.
- b. Nëpunësi mbahet në arrest në pritje të gjyqimit.
- c. Prania e nëpunësit në zyrë mund të pengojë hetimin disiplinor.
- d. Nëpunësi kryen detyrimet ushtarake.

113. Cili nga pohimet e mëposhtëme është më i saktë:

- a. Përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil bëhet nëpërmjet konkurimit të hapur dhe publik ku marrin pjesë kandidatë që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të pranimit nga brenda dhe jashtë shërbimit civil.
- b. Përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil bëhet nëpërmjet një konkurrimi transparent ku kanë të drejtë të marrin pjesë nëpunësit civil të klasifikuar në pozita të larta drejtuese ose në pozita të barazvlefshme me to.
- c. Përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil bëhet drejtpërdrejtë nga titullari i institucionit me vendin vakant.
- d. Përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil bëhet drejtpërdrejtë nga Qeveria e RKS për institucionet e ekzekutivit apo nga titullari i institucionit të pavarur apo komunës me vendin vakant.

114. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:

- a. Periudha provuese aplikohet në çdo rast në të cilin nëpunësi emërohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil.
- b. Periudha provuese nuk aplikohet në rast se nëpunësi është punësuar në një pozitë tjetër nëpërmjet ngritjes në karrierë.
- c. Periudha provuese aplikohet në çdo rast në të cilin nëpunësi emërohet në një pozitë tjetër të një kategorie funksionale më të lartë.
- d. Periudha provuese aplikohet në çdo rast në të cilin nëpunësi emërohet në një pozitë tjetër të një grade më të lartë.

115. Cili nga dënimet e mëposhtëm NUK përbën masë disiplinore në shërbimin civil të Kosovës:

- a. Vërejtje gojore.
- b. Vërejtje me shkrim që vendoset në dosjen personale të shërbyesit civil.
- c. Dënim me gjobë deri 50% të pagës mujore.
- d. Pezullimi nga puna dhe ndalimi i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj.

116. Cila nga të drejtat e mëposhtëme nuk përbën të drejtë themelore për një nëpunës civil në hetim disiplinor për kryerjen e një shkeljeje disiplinore?

- a. E drejta për të ditur akuzën dhe bazat e saj;
- b. E drejta e mbulimit nga kostos për ndihme juridike
- c. E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u përgjigjur;
- d. E drejta e ankesës.

117. Moshë e pensionit të nëpunësve civilë të Kosovës është:

- a. 65 vjeç për nëpunësit e gjinisë mashkullore dhe 60 vjeç për nëpunësit e gjinisë femërore.
- b. 70 vjeç për nëpunësit e gjinisë mashkullore dhe 65 vjeç për nëpunësit e gjinisë femërore.
- c. Gjashtëdhjetepesë (65) vjeç.
- d. Nuk ka një moshë të caktuar pensioni.

118. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:

- a. Në shërbimin civil të Kosovës, pensionimi është një e drejtë që nëpunësi mund ta ushtrojë kur plotëson disa kushte të caktuara (psh, mosha dhe vitet e kontributit).
- b. Në shërbimin civil të Kosovës, pensionimi është një e drejtë dhe detyrim dhe nëpunësi del në pension kur mbush moshën përkatëse, duke mos patur më të drejtë të qëndrojë në detyrë.
- c. Në shërbimin civil të Kosovës, pensionimi është një e drejtë dhe detyrim dhe nëpunësi del në pension kur mbush moshën përkatëse dhe vitet e kontributeve, duke mos patur më të drejtë të qëndrojë në detyrë.

119. Kundër vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikqyres të Shërbimit Civil të Kosovës, pala e pakënaqur:

- a. Nuk mund të paraqesë ankim;
- b. Mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente.
- c. Mund të ankimohet në gjykatën Kushtetuese të Kosovës.
- d. Mund të ankimohet në Kuvendin e Kosovës.

120. Këshilli i Pavarur Mbikqyres i Shërbimit Civil të Kosovës, kur gjykon se akti i shkarkimit nga detyra të një nëpunësi civil është i paligjshëm, mund të:

- a. Vendos kthimin në detyrë të nepunesit.
- b. Vendos kalimin e tij në një listë pritje dhe emërimin në pozitën e parë që do të behet vakante në të ardhmen.
- c. Vendos marrjen e një mase disiplinore ndaj personit apo personave përgjegjës për shkarkimin e paligjshëm.
- d. Te rekomandojë kthimin në pozitën e mëparshme të nepunësit të shkarkuar.

121. Cili nga pohimet e mëposhtëme, NUK është e drejtë e Këshillit të Pavarur Mbikqyres të Shërbimit Civil të Kosovës?

- a. Të njoftoje me shkrim kryeministrin, dhe eprorin e drejtpërdrejt të personit përgjegjës për ekzekutim, nëse ky i fundit nuk e ka zbatuar brenda afatit të parashikuara nga ligji vendimin e KPMSH-së.
- b. Te marrë një masë disiplinore ndaj personit apo personave përgjegjës për shkarkimin e paligjshëm të një nëpunësi.
- c. Të vizitojë çdo vend ku janë të punësuar nëpunësit civilë;
- d. Te ketë qasje dhe t'i kontrollojë të dhënat me shkrim lidhur me punësimin, emërimin, procedurat disiplinore dhe avancimin e nëpunësve civilë.

Kreu 1: Pyetje të llogjikës – matematikë bazike

- 122. Nëse 200 metra kablo optike kushton 240 Euro, sa do të kushtojnë 25 cm kablo optike?**
- a. 1.2 euro
 - b. 1.3 euro
 - c. 0.3 euro
 - d. 3 euro
- 123. Cili nga numrat më poshtë është më i madh se $\frac{1}{2}$?**
- a. $\frac{2}{5}$
 - b. $\frac{4}{7}$
 - c. $\frac{4}{9}$
 - d. $\frac{5}{11}$
 - e. $\frac{6}{13}$
- 124. Nëse një objekt zhvendoset me 5 metra në sekondë, sa metra mund të zhvendoset objekti në 1 orë:**
- a. 30
 - b. 300
 - c. 720
 - d. 18000
- 125. Çdo pasticier mund të bëjë 2 torta të mëdha ose 35 torta të vogla në një orë. Pasticeria është e hapur për 2 orë dhe nevojiten të bëhen për një feste 20 torta të mëdha dhe 700 të vogla. Sa pastiçierë nevojiten?**
- a. 19
 - b. 15
 - c. 20
 - d. 25
- 126. Për dy vjet, im atë do të jetë saktësisht tre herë më i madh në moshë sesa jam unë tani. Im atë është 37 vjeç. Sa vjeç jam unë?**
- a. 12
 - b. 13
 - c. 14
 - d. 15

127. Një roman i Ismail Kadarese mund të blihet, në një librari të Prishtinës për 20 Euro, në versionin me kapak lluksi dhe për 10 Euro në versionin si libër xhepi. I njëjti roman në versionin me kapak lluksi mund të blihet në internet me një ulje për 30% nga çmimi i kopertinës duke paguar 1 Euro shtesë për shpenzimet e spedicionit. Sa më i madh është çmimi i romanit me kopertinë lluksi i blerë në internet nga çmimi i romanit si libër xhepi i blerë në librarinë e Prishtinës?
- 6 Euro
 - 3 Euro
 - 4 Euro
 - 5 Euro
128. Nëna e dërgoi Lirinë në dyqan për të marrë 9 kuti konservash me bizele. Liria mund të mbante vetëm dy kuti në një rrugë. Sa herë iu desh të shkonte në dyqan për t'i marrë të gjitha?
- 3
 - 4.5
 - 5
 - 5.5
129. Cili nga numrat më poshtë është i barabartë me 25%
- $\frac{1}{25}$
 - $\frac{1}{4}$
 - $\frac{1}{3}$
 - $\frac{1}{2}$
130. Dyshemeja e një dhome është në formë drejtkëndore dhe ka përmasat 4 x 5 metra. Dyshemeja është veshur me pllaka me përmasa 25 x 25 cm. Duke supozuar se të gjitha pllakat janë të plota, sa pllaka ka në dyshemenë e dhomës?
- 330
 - 430
 - 320
 - 500
131. Njëpunësi doli nga shtëpia në 07:15 për t'u ndodhur në zyrën e tij në Ministrinë e Financave në orën 08:00. Ai mbërriti në zyrë në orën 07:52. Sa minuta iu deshën atij për të mbërritur në zyrë?
- 35 minuta
 - 37 minuta
 - 45 minuta
 - 47 minuta

132. Iliri ka një kartë debie, me overdraft me një interes ditor 0.5% për shumat në overdraft. Sa është shuma e interesit (në total) që do të paguajë Iliri për një shumë prej 250 euro në overdraft për një total prej 30 ditësh.

- a. 37.5
- b. 3.78
- c. 253.75
- d. 253.78

133. Arbeni ka në çantë 6 lapsa me ngjyra të ndryshme. Ai merr pa parë ngjyrat, vetëm dy lapsa. Sa kombinime të ndryshme të ngjyrave mund të ketë në dy lapsat e marrë nga Arbeni:

- a. 6
- b. 15
- c. 30
- d. 36

134. Vjosa mbështolli tabelën e saj me letër me ngjyrë. Tabela ishte 74 cm e gjerë dhe 44 cm e gjatë. Sa cm letër me ngjyrë iu nevojiti asaj për të mbështjellë tabelën?

- a. 236 cm²
- b. 592 cm²
- c. 3146 cm²
- d. 3256 cm²

135. Iliri po mblidhte të dhëna që të ndihmonte familjen e tij për të hartuar buxhetin. Ai kishte shënuar shpenzimet e tyre për ushqim për 4 javë rresht. Ata kishin shpenzuar 9.735 euro, 8.807 euro, 9.198 euro dhe 9.620 euro. Cila është mesatarja e shpenzimit të tyre për ushqim për 4 javë?

- a. 9.003 euro
- b. 9.271 euro
- b. 9.340 euro
- c. 9.406 euro

136. Tavani i një dyqani në formë drejtkëndëshi ka përmasat 12 x 18 m dhe është veshur me panela katrore 1x1m. Secili panel peshon çerek kilogrami. Sa është pesha totale e paneleve të përdorur për veshjen e tavanit?

- a. 36 kg
- b. 54 kg
- c. 121 kg
- d. 216 kg

137. Koha e reagimit për 5 telefonata për ndihmë që mori një punonjës i shërbimit zjarrëfikës ishin 38 minuta, 2 minuta, 32 minuta, 8 minuta dhe 25 minuta. Cila ishte koha mesatare e reagimit?
- 2 minuta
 - 21 minuta
 - 38 minuta
 - 105 minuta
138. Iliri ka 2000 aksione me një vlerë tregu prej 4.8 Euro secili. Vitin e fundit ai përfitoi një dividend prej 240 Euro. Sa është përqindja vjetore e fitimit për aksion?
- 0.025%
 - 2%
 - 2.5%
 - 40%
139. Vjosa procesoi 300 kërkesa për licence gjatë muajit Qershor. Gjatë muajit Korrik ajo procesoi 10% kërkesa për licencë më pak. Sa kërkesa për licencë procesoi ajo gjatë muajit korrik?
- 220
 - 240
 - 270
 - 280
140. Shkolla "Edit Durham" ka pasur një buxhet 9 herë më të madh se shkolla "Bajram Curri". Nëse buxheti vjetor i të dyja shkollave së bashku është 1,000,000 Euro, sa është mesatarisht buxheti mujor i shkollës "Bajram Curri"?
- 8,111.00
 - 8,222.22
 - 8,333.33
 - 8,444.44
141. Koha e parashikuar për zhvillimin e një testi me 100 pyetje është 3 ore e 1/3. Dhjetë (10) aplikantë morën testin dhe e përfunduan për 3 orë. Sa është diferenca mesatare ndërmjet kohës së 10 aplikantëve dhe kohës së parashikuar për zhvillimin e një testi për çdo pyetje?
- 10 sekonda për çdo pyetje
 - 12 sekonda për çdo pyetje
 - 14 sekonda për çdo pyetje
 - 16 sekonda për çdo pyetje

142. Nëse ora e New York është tre orë para orës së San Franciskos, sa është ora në New York nëse një sahat në San Francisko është një orë mbrapa dhe tregon pikërisht orën 4?
- a. 1
 - b. 6
 - c. 7
 - d. 8
143. Një nëpunës voziti nga Prishtina për të marrë pjesë në një seminar pune në Durrës. Distanca totale për udhëtimin vajtje-ardhje ishte 240 km. Koha e vozitjes nga Prishtina në Durrës në vajtje është 2 orë. Në kthim për shkak të trafikut u nevojiti një orë më shumë. Mesatarisht sa më avash ka udhëtuar nëpunësi në kthimin për në Prishtinë sesa në vajtje?
- a. 15 km/orë më avash
 - b. 35 km/orë më avash
 - c. 40 km/orë më avash
 - d. 80 km/orë më avash
144. Dy kamiona kryejnë një udhëtim me gjatësi 1680 km. Kamioni i parë bën mesatarisht 14 km me një litër karburant dhe i dyti 12 km me një litër karburant. Sa litra karburant më shumë u konsumuan nga kamioni i dytë në krahasim me kamionin e parë?
- a. 10
 - b. 20
 - c. 30
 - d. nuk është e mundur të gjendet rezultati me të dhënat më sipër.
145. Ashensori i një qendre tregtare ndalon në secilin nga katet e ndërtesës. Nëse lartësia e një kati është 5 metra dhe ashensori udhëton me shpejtësi të barabarte me 7.5 metra në sekondë, sa është përafërsisht koha e nevojshme për të arritur në katin e 68 të ndërtesës.
- a. 2 sekonda
 - b. 9 sekonda
 - c. 38 sekonda
 - d. 45 sekonda
 - e. 510 sekonda

146. Në muajin Janar numri i punonjësve në një ndërmarrje shtetërore u ul me 8%. Në muajin Korrik, menjëherë pas zgjedhjeve, numri i punonjësve në të njejtën ndërmarrje u rrit me 8%. Numri total i punonjësve përpara reduktimit të Janarit ishte 326. Sa ishte, përafërsisht, numri i punonjësve të ndërmarrjes mbas rritjes në Korrik?
- 307
 - 318
 - 324
 - 326

Kreu 3: Pyetje të llogjikës – arsytuese, deduksionit dhe të aftësive për zgjidhjen e problemeve

147. Faktet: Zyra e Vjosës është dy kate mbi zyrën e Valdetes. Zyra e Valdetes është 1 kat më poshtë zyrës të gruas së vetme në ndërtesë që ka datëlindjen sot. Zyra e Sarandës është në katin e tretë, ndërsa zyra e Vjosës është në katin e katërt. Konkluzioni: Sot Vjosa ka datëlindjen.

Cila nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:

- Faktet e mësipërme e konfirmojnë konkluzionin.
 - Faktet e mësipërme nuk e konfirmojnë konkluzionin.
 - Faktet e mësipërme as nuk e konfirmojnë as nuk e hedhin poshtë konkluzionin.
148. Pjesa më e madhe e familjes Hoxha, jetojnë në Suharekë. Shumë banorë të Suarekës e festojnë festën e Bajramit. Mehdiu është një nga anëtarët e familjes Hoxha. **Bazuar në këto fakte ne mund të arrijmë, me siguri, në konkluzionin se:**
- Mediu jeton në Suharekë.
 - Mediu nuk e feston festën e Bajramit
 - Të gjithë Hoxhat e festojnë festën e Bajramit.
 - Asnjë nga pohimet e mësipërme.

149. Dritani duhet të vozitë nëpërmjet Austostradës së re për të shkuar në punë. Dritani ka sot në orën 9.00 një takim të rëndësishëm. Nëse Dritani nuk arrin në takimin e orës 9.00 ai mund të humbë rastin për lidhjen e një kontrate të rëndësishme. Autostratada e re është e mbyllur sot përgjatë gjithë dites për shkak të riparimeve të nevojshme në rrugë. **Bazuar nga sa më sipër, ne mund të arrijmë në konkluzionin se:**

- Dritani nuk do të jetë në gjendje të shkojë në punë.
- Dritani ndoshta nuk do të mund të caktojë një orë tjetër për takimin e rëndësishëm.
- Dritani do të humbë kontratën në fjalë
- Asnjë prej pohimeve të mësipërme.

150. Vjosa raportoi në polici se dje vonë, ndërsa ishte në lift, duke zbritur nga zyra, në katin e 15 të ndërtesës së ministrisë, një burrë që kishte hipur në lift në katin e 12, i kishte rëmbyer celularin. Ajo i tha policisë, gjithashtu, se kishte përshtypjen se burrin në fjalë e kishte parë edhe më përpara në ndërtesën e ministrisë. Studio përshkrimin e mëposhtëm që Vjosa i bëri policisë për burrin në fjalë. **Cili nga përshkrimet e mëposhtëme të Vjosës, do të ishte më i dobishëm për të gjetur burrin në fjalë, nëse supozohet se ai punon në ndërtesën e ministrisë:**

- a. Atij i vinte erë goja.
- b. Ai mbante një kravatë të verdhë.
- c. Ai kishte një nishan të madh në ballë.
- d. Ai mbante një dosje të kuqe.

151. Kyeinspektori i sigurisë ushqimore që mbulon territorin e komunës së Prishtinës, përpiket të kryejë një shërbim cilësor për sigurinë ushqimore të qytetarëve të Prishtinës, ndërsa në të njejtën kohë duhet të përdorë burimet financiare në dispozicion në mënyrë efëiente. Kështu Kryeinspektori duhet të marrë në konsideratë disa faktorë kur përdor burimet në dispozicion. Psh. nëse është pushimi i fund javës, inspektorët shtesë duhet të dalin në punë. Sidoqoftë nëse inspektorët shtesë dalin në punë në fundjavë, është e nevojshme që çdo herë të kërkohet paraprakisht autorizim nga ministria për shkak të pagesës të orëve jashtë orarit. **Bazuar nga sa më sipër, ne mund të arrijmë në konkluzionin se:**

- a. nëse është pushimi i fund javës, nuk është e nevojshme të kërkohet autorizim nga ministria.
- b. nëse nuk është pushimi i fund javës, është nevojshme të kërkohet autorizim nga ministria.
- c. nëse nuk kërkohet autorizim nga ministria atëherë nuk është pushimi i fund javës.
- d. nëse autorizimi nga ministria nuk është i nevojshëm, atëherë është pushimi i fund javës.

152. Iliri po përpiket të gjejë një vend të përshtatshëm për të hapur një dyqan lodrash në qytetin e Pejës. Ai po kërkon një vend që është tamam në qendër të qytetit ose jo larg saj dhe që do të tërhiqte blerës që bëjnë shopping në këmbë. **Cila nga vendet e mëposhtme do të ishte më i përshtatshmi, për dyqanin e Ilirit, sipas kërkesave të mësipërme:**

- a. një dyqan i vogël tre blloqe nga bulevardi kryesor i Pejës, që gjendet përballë një shkolle fillore dhe pranë një dyqani që shet ëmbëlsira.
- b. një dyqan i veçuar në buzë të një rruge rezidenciale që ndodhet rreth 5 blloqe nga bulevardi kryesor i Pejës.
- c. një dyqan luksoz në një ndërtesë të sapo inaguruar shumë afër qendrës të qytetit ngjitur me stacionin e trenit, ku kryesisht udhëtojnë të rinjtë dhe profesionistët pa fëmijë që udhëtojnë drejt Prishtinës për çdo ditë.
- d. Një dyqan në një qendër tregtare të vogël që gjendet në periferinë e qytetit dhe që në pjesën më të madhe ka dyqane që tregtojnë pjesë këmbimi për makina.

153. Doktor Sala, ka një klinikë dentare pediatrike (për fëmijë) dhe ka nevojë për një higjenist të aftë dhe të besueshëm për ta ndihmuar në klinikën e tij. Dy personat e fundit që punësoj i ishin rekomanduar nga disa kolegët e tij dentistë, por secili nuk zgjati më shumë se një muaj në punë. **Cilën nga kandidatët e mëposhtëm duhet të punësojë doktor Sala:**

- a. Saranda që ka qenë higjeniste për 15 vjet dhe për të cilën punëdhënësi i tanishëm i së cilës është në prag të pensionimit, thotë që është më e mira në treg. Klientela për të cilën ajo ka punuar përbëhet nga njerëzit më të pasur të qytetit.
- b. Vjosa që sapo është diplomuar në një nga programet më të mira të Kosovës për higjenist dentar. Vjosa përpara se të bëhej higjenist dentar ka punuar për rreth dy vjet në një qendër ditore për fëmijët.
- c. Ademi që ka punuar si higjenist dentar, për tre vjet në një klinikë shtetërore shëndetësore. Ademi është shumë i interesuar të fillojë një punë në klinikë dentare private.
- d. Fitojra që është një higjeniste dentare me eksperiencë dhe shumë e rekomanduar dhe që gjithashtu po perfundon studimet për arsimitare parashkollore, që shpreson ta ndihmojë për të gjetur një punë si edukatore kopshti, pasi ka dashur gjithmonë të punojë me fëmijët.

154. “Inspektorati fito-sanitar i Kosovës, është i alokuar në Prishtinë dhe përbëhet nga 15 grupe të lëvizshme të inspektimit fito sanitar të Republikës. Pjesa më e madhe e grupeve të inspektorëve kryejnë inspektime në pikat e kalimit të kufirit të Kosovës. Disa gupe inspektimi kryejnë inspektime në qendrat e mëdha urbane larg prej pikave të kalimit të kufirit.”

Bazuar në paragrafin më sipër, konkluzioni më i saktë që do të mund të arrihej është se:

- a. Pjesa më e madhe e grupeve të inspektimit kryejnë detyrë larg pikave të kalimit të kufirit.
- b. Asnjëri nga grupet e inspektimit nuk është i përjashtuar nga kryerja e detyrës në seicilin nga vendet ku është e nevojshme.
- c. Grupet e inspektimit që kryejnë detyrën në qendrat e mëdhaja urbane nuk është e nevojshme të lëvizin në pjesë të tjera të vendit.
- d. Pak grupe inspektimi kryejnë detyrën në pikat e kalimit të kufirit.

155. Gjatë 6 viteve të fundit numri i doktorëve është rritur me rreth 20%. Gjatë të njejtës periudhë, numri i menaxherëve në sistemin shëndetësor është rritur me 600%. Këto përqindje tregojnë se shumë doktorë kanë humbur pushtetin për të përcaktuar oraret e tyre të operacioneve dhe vizitave, të përcaktojnë çmimet e këtyre dhe të vendosin mbi recetat që japin.

Bazuar në paragrafin më sipër, konkluzioni më i saktë që do të mund të arrihej është se doktorët:

- a. janë të indinjuar me ndërhyrjen e menaxherëve.
- b. nuk kanë më trajnimin e duhur.
- c. kujdesen më shumë për pacientët e tyre.
- d. janë më pak të pavarur se ç'ishin më përpara.
- e. po bëjnë më pak pare se ç'benin më përpara.